

1 E hënë, 8 nëntor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hynë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëdita,
6 të gjithëve. Mirë se erdhët.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar
9 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-07, Prokurori i
10 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.
12 Bolici, ju lutem, prezantoni ekipin tuaj.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.
14 Në emër të ZPS-së sot të pranishëm janë Matthew Halling,
15 Ndhmësprokuror; James Pace Ndhmësprokuror; Line Perderson,
16 Menaxhere e Lëndës dhe e Provave; Molly Norburg, stazhiere e
17 brendshme; dhe unë jam Valeria Bolici, Prokurore pranë ZPS-
18 së.

19 Dua t'ju informoj, të nderuar Gjykatës, se z. Halling do
20 të duhet të largohet nga sallë pasi t'i drejtohet Trupit
21 Gjykues në lidhje me pikën A, për shkak të angazhime të tjera
22 të ngutshme të punës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Pa
24 problem. Faleminderit.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] Më quajnë Jonathan Rees, jam avokat.
2 Paraqitem në emër të z. Hysni Gucati. Ndihmohem nga Huw Bowden
3 bashkëmbrojtës; Znj. Faye Wigmore.

4 PËRKTHYESI: Vëren se nuk i kapi të gjithë emrat.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

6 Faleminderit.

7 Z. Cadman.

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita. Quhem Toby Cadnam,
9 përfaqësoj z. Nasim Haradinaj. Këtu kam z. Carl Buckley, Znj.
10 Miriam Boxberg do të na bashkohet më pas sot.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vërej se
12 z. Gucati dhe Z. Haradinaj janë të pranishëm në sallë.

13 Trupi Gjykses ka lëshuar një urdhër ditën e premte sa i
14 takon rendit të ditës sot. Do të fillojmë me parashtrimet sa i
15 takon kërkesës për certifikim të Prokurorisë, e cila është
16 protokolluar të premtën që shkoi. Pastaj do të vijojmë me
17 hapat në vijim, me parashtrimet për hapat në vijim. Pastaj do
18 të trajtojmë disa çështje. Dhe, në fund fare, do të dëgjojmë
19 deklaratat e të akuzuarve.

20 Do të fillojmë pikën e parë në rendin e ditës.

21 Më datë 3 nëntor të vitit 2021, Trupi Gjykses, nxori një
22 vendim konfidencial për çështjet sipas rregullit 102(3) që
23 ende nuk kanë marrë zgjidhje me afat nxjerrjeje për datën 5
24 nëntor për ZPS-në.

25 Më datë 5 nëntor 2021 Prokuroria kërkoi certifikim të

1 këtij vendimi dhe pezullim të afatit të lartpërmendur. Trupi
2 Gjykues e shtyu afatin e nxjerrjes për deri në fund të ditës
3 sot. Trupi Gjykues do të dëgjojë parashtrimet e bëra
4 gojarisht.

5 Secili ekip i Mbrojtjes ka 15 minuta për t'u përgjigjur.
6 Pastaj ZPS-së do t'i jepen 15 minuta për kundërpërgjigje.
7 Trupi Gjykues mund të ketë pyetje.

8 Edhe pse vendimi i 3 nëntorit dhe kërkesa për certifikim
9 e ZPS-së janë protokolluar në mënyrë konfidenciale, pjesa më e
10 madhe e çështjeve të ngritura mund të diskutohej në seancë
11 publike. Palët mund të kërkojnë të kalojnë në seancë private
12 nëse përmbajtja e ndonjë prej materialeve sipas rregullit
13 102(3) ka nevojë të diskutohet kështu.

14 Nuk do të kemi parashtrime me shkrim për këtë. Trupi
15 Gjykues do të nxjerrë një vendim me shkrim brenda fundit të
16 ditës së sotme.

17 Zonja Sekretare, do të mbaj shënim kohën në mënyrë që t'i
18 qëndrojmë besnikë këtij parashikimi.

19 Z. Rees, keni fjalën.

20 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do bëj çmos që
21 t'i qëndroj 15 minutave. Por unë me sa kam dijeni, ZPS-ja ka
22 bërë një parashtrim me shkrim lidhur me kërkesën fillestare.

23 Ne kemi kundërshtim për kërkesën për leje për apelim. E
24 fillojmë me kuadrin ligjor që është parashikuar në vendimin e
25 Gjykatësit të Procedurës Paraprake në këtë çështje, që është

1 KSC-BS-2020-07, me numër F169, në paragrafin 10 e tutje.

2 E thënë në përmbledhje, e drejta për apelim lind vetëm
3 nëse Trupi Gjykses është i mendimit se standardi i
4 certifikimit i parashikuar në nenin 45(2) të ligjit dhe
5 rregullit 77(2) të Rregullores janë përmbushur. Apelimet e
6 ndërmjetme të cilat e ndërpresin vijimësinë e procesit,
7 përbëjnë përjashtim. Duhet mbajtur parasysh se apelimi i
8 ndërmjetshëm do të trajtonte çështje themelore ose do të duhej
9 të ishte në përfitim për Dhomat e Specializuara dhe vetëm kjo
10 mund të kërkonte një certifikim të apelimt.

11 Duke pasur parasysh natyrën kufizuese të kësaj mase,
12 duhet që të zbatohen këto kërkesa: Së pari, çështja të jetë
13 një çështje e apelueshme dhe çështja në fjalë duhet që të
14 prekë, pra, të cenojë në mënyrë të konsiderueshme zhvillimin e
15 drejtë dhe të përshpejtuar të procesit; ose 2, rezultatin e
16 gjykimit; dhe, C, nëse sipas mendimit të Gjykatësit të
17 Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykses një zgjidhje e
18 ndërmjetme do të ishte në përfitim për procedurën e mëpasshme.

19 Temat e identifikueshme apo që janë objekt i zgjidhjes
20 janë me rëndësi për të përcaktuar se çfarë çështjesh lindin
21 nga shkaku gjyqësor që është duke u ekzaminuar. Një çështje e
22 apelueshme kërkon që të jetë e lidhur me çështje konkrete që
23 gjykohen dhe jo me shqetësime hipotetike apo çështje
24 abstrakte.

25 Njëra alternativë e kërkesës për certifikim - më falni -

1 njëra anë e kësaj kërkesë për certifikim përmban dy
2 alternativa. Çështja duhet të ketë reperkusione të
3 konsiderueshme; dhe, së dyti, duhet që të shikojë se si ky
4 testim e bën të ditur që subjekti që paraqet kërkesën duhet që
5 të tregojë, pra, të dëshmojë efektet e çështjes në fjalë.

6 Zhvillimi i drejtë dhe i përshpejtuar i procesit në
7 përgjithësi kuptohet se ka të bëjë me normat e gjykimit të
8 drejtë. Drejtësia në këtë rast ruhet nëse palëve ju jepet
9 mundësia për të paraqitur provat e tyre apo për t'u dëgjuar
10 apo për t'u komentuar për vëzhgime të ndryshme në lidhje me
11 provat që i paraqiten Trupit Gjykses.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] z. Rees,
13 kanë kërkuar sërish që të ngadalësoni. E kuptoj që është e
14 vështirë po...

15 Z. REES: [Përkthim] Do bëj çmos. Po kam dhe 15
16 minutëshin si kufizim.

17 Aspekti i parë i këtij testi të certifikimit cenon
18 rezultatin e procesit. Prandaj duhet parë, duhet shqyrtuar
19 pra, nëse ndonjë gabim i mundshëm në vendimin e ndërmjetëm do
20 të ndikonte në rezultatin e çështjes gjyqësore.

21 Aspekti tjetër i testit për certifikim është një faktor
22 tjetër shtesë kufizues. Për shkak të natyrës progresive
23 mosverifikimi nga ana e subjektit kërkuar të aspektit të parë
24 të këtij testimi do ta pengonte apo do ta përjashtonte Trupin
25 Gjykses që të shqyrtonte nëse është përmbushur testi i dytë

1 apo jo.

2 Certifikimi nuk ka të bëjë nëse vendimi është i arsyetuar
3 siç duhet por nëse është përmbushur standardi për
4 certifikimin.

5 Duke zbatuar këto parime, parashtrimi ynë i parë është se
6 çështjet, siç janë përpiluar në paragrafin 2 të kërkesës, nuk
7 janë çështje të apelueshme.

8 Ato përbëjnë orvatje për të fabrikuar çështje të
9 apelueshme nga konkluzionet e Trupit Gjykues me të cilat ZPS-
10 ja thjeshtë nuk bie dakord. Të gjitha çështjet që ngrihen
11 përbëjnë, në thelb, thjesht mospajtim dhe në një sërë
12 aspektesh keqinterpretim të vendimit që kundërshtohet nga
13 kërkesa. Këto janë çështje hipotetike dhe abstrakte.

14 Paragrafi 2.1 supozon, si bazë për çështjen e vetë
15 hipotetike se materialiteti nga Trupi Gjykues është vlerësuar
16 në formë abstrakte. Por, nuk është kështu. Nuk është ky rasti.
17 Dhe kjo del qartë nga objekti dhe shpjegimi i vendimit të
18 Trupit Gjykues.

19 Paragrafi 2.2 nuk mban parasysh faktin sesi Gjykatësi i
20 Procedurës Paraprake, Paneli i Gjykatës së Apelit por edhe ky
21 Trup Gjykues, në raste të tjera më përpara janë pajtuar se
22 vlerësimi nëse pretendimet për shtytje në kryerjen e krimit
23 janë tërësisht -- nëse janë apo jo joprobabile janë çështje të
24 cilat duhen konstatuar nga Trupi Gjykues dhe se nxjerrja duhet
25 bërë aty ku është me rëndësi materiale për përgatitjen nga e

1 Mbrojtjes apo kur është shfajësuese. Nuk është se parashikohet
2 ndonjë kusht për nxjerrjen në Rregullore.

3 Paragrafi 2.3 përsëri përbën një çështje hipotetike
4 përpiluar në bazë të supozimit se pretendimet bazë, në të
5 cilat ajo mbështetet sa i takon shtytjes për kryerjen e
6 krimit, janë të pabazuara.

7 Unë dua të them se kjo çështje kërkon që të fusë pragje
8 të reja, që nuk janë të bazuara dhe janë thjesht të fantazuara
9 për t'u marrë parasysh sa i takon pretendimeve për shtytjen e
10 krimit. I vetmi vlerësim që është relevant për këtë bëhet
11 gjatë gjykimi, gjatë paraqitjes, pra, të argumenteve lidhur me
12 këtë.

13 Nuk është tërësisht joprobabël edhe po të mos ishte i
14 bazuar edhe po të ishte i fantazuar, sepse përsëri barra i bie
15 Prokurorisë për të vërtetuar se nuk ka pasur nxitje nga ana e
16 policisë. Por, çështja në paragrafi 2.1.3 është tërësisht një
17 çështje hipotetike.

18 Në paragrafi 2.4 nuk kemi një çështje që qëndron më vete.
19 Është e vështirë madje për ta kuptuar këtë pyetje apo këtë
20 çështje siç është hartuar. Kundërmasat nuk janë alternative
21 ndaj nxjerrjes dhe janë alternative ndaj mosnxjerrjes. Në rast
22 të mosnxjerrjes sipas rregullit 108 masat kompensuese kërkohen
23 që të sigurojnë rregullsi, drejtësi ndaj të pandehurve.
24 Objekti i këtyre masave kompensuese mund të jetë vetëm ai që
25 përbën drejtësi dhe nuk duhet të kufizohet nga ZPS-ja.

1 Pra, në tërësi kjo pikë është hipotetike.

2 Asnjë prej këtyre çështje hipotetike nuk lind nga vendimi
3 që kërkohet të kundërshtohet. Këto janë, thjesht çështje
4 hipotetike dhe abstrakte që nuk janë thelbësore për t'u parë,
5 për t'u shqyrtuar nga Trupi Gjykses lidhur me nxjerrjen e
6 materialeve, në bazë të rrethanave dhe fakteve që dihen në
7 këtë çështje.

8 Në bazë të paragrafi 3 të kërkesës që i është bërë
9 Gjykatësit të Procedurës Paraprake - jo, më falni, korrigjim i
10 përkthimit - përmendja në paragrafin 3 të kërkesës të vendimit
11 të mëparshëm të Gjykatës Paraprake ku është mohuar nxjerrja --

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kanë mbetur dhe pesë
13 minuta.

14 PËRKTHYESI: Vijon përkthimi për avokatin.

15 Z. REES: [Përkthim] -- nuk duhet pasur -- nuk është
16 diçka e cila ka të bëjë me këtë. Paneli i Apelit nuk e ka
17 marrë në shqyrtim materialin që ka parë Trupi Gjykses.

18 Në bazë të vendimit procedural të Gjykatës së Apelit se
19 ZPS-ja ka zbatuar një qasje të ngushtë, që nuk duhet të ishte
20 kështu, e mbështet këtë çështje të relevancës.

21 Paragrafi 4 dhe 5 i kërkesës ose në paragrafin 4 dhe 5 të
22 kërkesës shikojmë që ZPS-ja në mënyrë të pasaktë përmend
23 vendimet e Trupit Gjykses sa i takon konstatimit lidhur me
24 raportin e brendshëm me materialet e tjera që mund të nxirren.

25 Në lidhje me paragrafi 6 dhe me kërkesën për efektin

1 pezullues të vendimit të kundërshtuar derisa të marrë
2 përgjigje kërkesa për certifikim. kjo është përmbajtja e këtij
3 paragrafi. Siç diskutuam ditën e premte, rregulli 171 nuk
4 lejon pasoja pezulluese deri në zgjidhjen e kërkesës për
5 certifikim por vetëm parashikon efektin, pra, pasojën
6 pezulluese që mund të jepet në momentin e certifikimit.

7 Dua tani që të flas me hollësi për çështjen e parë. Unë
8 jam i ndërgjegjshëm, se në këtë etapë, nuk jemi në gjendje të
9 argumentojmë për themelin. Por disa parashtrime i kam sepse
10 nëse shikojmë me hollësi këtë pjesë të kërkesës, ajo tregon se
11 çështjet e paraqitur janë çështje të cilat bazohen në një
12 premisë të rreme, që do të thotë se; aty pohohet se Trupi
13 Gjykses nuk ka bërë një vlerësim paraprak sesi një informacion
14 mund të mbështeste një çështje të paraqitur.

15 Kjo nuk është e saktë edhe në brendinë e kërkesës për
16 certifikim. Kjo parashtrohet në paragrafin 7 të kërkesës.

17 Trupi Gjykses ka parashtruar në vendimin në fjalë se
18 informacioni ka qenë me rëndësi materiale sipas rregullit
19 102(3), e interpretuar në kontekstin e vetë përkatës, duke
20 qenë se sugjeron që ZPS-ja nuk ka marrë masat e duhura
21 hetimore për të përjashtuar mundësinë që një anëtar i
22 personelit të saj apo dikush tjetër që të jetë në kontrollin e
23 saj të ketë shtytur të akuzuarin në kryerje të krimit përmes
24 dhënies së informacionit të kundërshtuar.

25 Rregulli 102(3), siç ka konstatuar Trupi Gjykses, kërkon

1 sigurisht nxjerrjen e të gjitha materialeve që konsiderojmë me
2 rëndësi materiale nga Mbrojtja për përgatitjen e vet. Dhe në
3 vendimin për nxjerrje, Trupi Gjykses e ka parashtruar qartë,
4 sesi rrethanat e kësaj çështjeje, e bëjnë këtë informacion me
5 rëndësi materiale për përgatitjen e Mbrojtjes. Kjo është
6 pikërisht një shembull i orvatjeve të ZPS-së për të sajuar një
7 problem për një gjë për të cilën ata thjesht nuk pajtohen.

8 Paragrafët 10 deri në 13. Trupi Gjykses ka pasur të
9 drejtë se bëhet fjalë për një çështje për të bërë një vlerësim
10 të provave të cilat mund të thirren në fund të procesit
11 gjyqësor. Nëse argumentimi i shtytjes ose paraqitja e
12 argumentit për shtytjen në kryerjen e krimit është apo jo
13 joprobabël, kjo i mbetet si barrë Prokurorisë për të provuar
14 të kundërtën.

15 Trupi Gjykses ka konstatuar tashmë se ZPS-ja ka në
16 zotërim material nga i cili mund të deduktohet se ZPS-ja nuk
17 ka mundur që ta përjashtojë mundësinë e shtytjes në kryerjen e
18 krimit.

19 Paragrafët 11 deri 13 përmbajnë një sërë pasaktësish. Në
20 rastin e provave të të akuzuarve por, madje edhe siç e di
21 Trupi Gjykses nga provat e paraqitura nga ZPS-ja, këto
22 materiale janë dorëzuar nga një person apo nga disa persona të
23 cilët të akuzuarit nuk i njihnin.

24 Pa cituar asnjë bazë për ato që parashtrojnë, ZPS-ja në
25 paragrafi 12, orvatet që të konfirmojë apo të fusë kërkesa të

1 reja sa i takon paraqitjes së argumentit për nxitje policore.
2 Ata orvaten që të fusin një kriter, pra, një kërkesë për t'u
3 përmbushur. Se ishte diçka që ishte thjesht një shkëmbim i
4 çastit apo kërkesa të tjera.

5 Asnjërin prej të cilave, pra, nuk e gjejmë në
6 jurisprudencën evropiane sa i takon paraqitjes së shtytjes në
7 kryerjen e krimit dhe ZPS-ja nuk citon asnjë bazë për këto
8 parashtrime. Fakti që i citojnë pa bazë mbështetëse, tregon
9 edhe njëherë, se ZPS-ja nuk e kupton qartë natyrën e
10 argumentit të shtytjes në kryerjen e krimit.

11 Në këtë çështje gjyqësore, ne parashtrojmë, se veprat
12 penale të pretenduara nuk do të kishin ndodhur pa dorëzimin e
13 këtyre materialeve nga ana e personave -- e një personi apo
14 disa personave të panjohur që ja kanë kaluar të akuzuarve këto
15 materiale.

16 Nëse ka qenë i përfshirë një zyrtar i ZPS-së në këtë
17 proces, kjo mund të ishte njësoj si në shtytjen e kryerjes së
18 krimit njësoj si në rastet kur një punonjës i policisë merr
19 pjesë në lëvrimin e një sasive të madhe të drogave të forta një
20 individ i cili nuk është përfshirë kurrë më parë në trafikim
21 të drogave. Sigurisht në këtë rast kjo ngre dyshime të forta.

22 Parashtrimi i paragrafit 3 të kërkesës që shtytja në
23 kryerjen e krimit në këto rrethana është teorike, është i
24 palogjikshëm dhe nuk përputhet me konstatimin e Trupit Gjykses
25 që ZPS-ja ka në zotërim material që në mënyrë të arsyeshme

1 mund të sugjeronte që ata nuk e përjashtojnë dot mundësinë
2 vetë.

3 Paragrafi 14 dhe 15 i kërkesës thotë se ZPS-ja e ka
4 parasysh se natyra tërësisht joprobabël e shtytjes së kryerjes
5 së krimit duhet që të vlerësohet ndryshe duke pasur parasysh
6 nxjerrjen në dallim nga themeli i çështjes që po gjykojmë.
7 Është përtej aftësisë tonë --

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,
9 e keni kaluar kufirin.

10 Z. REES: [Përkthim] Me siguri që z. Cadman nuk e ka
11 problem nëse i ha nga koha.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në
13 rregull. Mirë.

14 Z. CADMAN: [Përkthim] Po s'e kemi problem.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
16 mbajmë, do ta konsiderojmë të përbashkët kohën tuaj.

17 Z. Rees, a keni a jeni afër fundit?

18 Z. REES: [Përkthim] Po ja, pak nga pak po i afrohem.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kjo nuk
20 është përgjigje e drejtpërdrejtë.

21 Z. REES: [Përkthim] Po përpiqem që të marrë në trajtim
22 parashtrimin e bërë me shkrim nga ZPS-ja.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.
24 Pastaj do të marrim nga koha e z. Cadman.

25 Z. REES: [Përkthim] Nxjerrjes sipas rregullit 102 dhe 3

1 [sipas përkthimit] nuk kërkon ndonjë testim privat *prima facie*
2 të pragut që duhet të vërtetohet Mbrojtja lidhur me ndonjë
3 pistë mbrojtjeje apo problematikë. Po të ishte kështu,
4 Prokuroria mund ta mbante materialin vetë ndërkohë që
5 Prokuroria do ta dinte se ky material mund të ishte për
6 shembull shfajësues edhe pse Mbrojtja mund të mos ishte në
7 dijeni të natyrës shfajësuese të materialit në fjalë.

8 Në fakt edhe nëse Mbrojtja mund të mos jetë në dijeni të
9 ekzistencës së materialit dhe të zotërimit nga ana e
10 Prokurorisë apo të problemit me të cilin ai lidhet, sepse
11 Mbrojtja sigurisht nuk e ka materialin në fjalë.

12 Kushtet për nxjerrjen në rregullin 102(3) janë të
13 paraqitura vetë aty.

14 Pra, në rregullat 102 dhe 103 të paraqitura dhe të
15 përshkruara qartë në brendinë e këtyre rregullave.

16 Ne vërejmë se ZPS-ja nuk e kundërshton qasjen e Trupit
17 Gjykues se kredibiliteti, besueshmëria dhe pesha e
18 informacionit nuk duhet që të merret parasysh për qëllimet e
19 nxjerrjes. Ata nuk kundërshtojnë këtë. ZPS-ja kundërshton që
20 Gjykata të mos njohë një aspekt të kësaj çështjeje. Është një
21 fjalë e cila aty nuk kuptohet qartë si e lidhur me argumentin.

22 Në paragrafin 18 edhe njëherë ZPS-ja, pa cituar bazë,
23 përpiqet që të përfshijë kërkesat të reja sa i takon shtytjes
24 në kryerjen e krimit. Në këtë rast është që argumenti s' duhet
25 të jetë i fantazuar apo që duhet të jetë i mbështetur.

1 Edhe njëherë, ne e përsërisim atë që kemi thënë edhe
2 shumë herë të tjera, që argumenti i shtytjes në kryerjen e
3 krimit, me përjashtim të rastit kur është krejt joprobabël, të
4 duhej që të kundërshtohet nga ZPS-ja, pra barra e provës për
5 ta kundërshtuar këtë duhet t'i kalonte ZPS-së, pra, për të
6 përjashtuar faktin se nuk ka pasur shtytje në kryerjen e
7 krimit.

8 Nëse ZPS-ja nuk mund ta përjashtojë këtë mundësi,
9 atëherë, vetëm atëherë, ky argumentim mund të konsiderohet si
10 tërësisht joprobabël. Vërejmë edhe njëherë se kjo kërkesë nuk
11 kërkon që të argumentojë se Trupi Gjykses nuk vepruar saktë
12 kur ka arritur në përfundimin se materiali në mënyrë të
13 argumentueshme sugjeron se ZPS-ja nuk mund ta përjashtojë
14 mundësinë e kryerjes së krimit.

15 Paragrafët 19 dhe 20 edhe njëherë, përpiqen që të
16 përshkruajnë diçka si një problem të katërt. Edhe njëherë,
17 qasja e ZPS-së nuk është e saktë në faktin që masat
18 kompensuese nuk janë alternativë e nxjerrjes. Ato janë
19 alternativë e mosnxjerrjes së materialit, kur urdhërohet sipas
20 rregullit 108.

21 Nuk ka asnjë sugjerim në kërkesën për certifikim se
22 konkluzioni i Trupit Gjykses se masat kompensuese të
23 propozuara nuk e vendosin Mbrojtjen në atë pozitë që do të
24 siguronte kontekstin përkatës të përpjekjeve të ZPS-së për të
25 përjashtuar mundësinë se informacioni ka rrjedhur me dashje

1 nga një prej punonjësve të saj. E gjitha kjo është e pasaktë.

2 Edhe këtu kjo çështje që ngrihet nga kërkesa është
3 hipotetike ashtu siç është hartuar. Edhe pse nuk kanë mbaruar
4 ende provat e Prokurorisë dhe nuk ka filluar ende paraqitja e
5 provave nga Mbrojtja, kjo kërkesë përpiqet që ta kornizojë
6 këtë çështje hipotetike në ato rrethana ku ZPS-ja nuk mund ta
7 përjashtojë këtë mundësi.

8 Kjo është një orvatje nga ZPS-ja për të fabrikuar, pra,
9 për të sajuar një çështje, një problem nga një konkluzion i
10 cili thjesht atyre nuk i pëlqen.

11 Ne themi se këto çështje ose më saktë se nuk ka çështje
12 të apelueshme. Këtu bëhet fjalë për diçka tjetër në paragrafin
13 21 deri në 23, për hirë të plotësisë, ne themi se kjo kërkesë
14 ndikon negativisht në zhvillimin e këtij procesi. Të vetmet
15 pasoja që do të kishte kjo kërkesë, po qe se do miratohej, do
16 të ishte futja e vonesave, pra, shkaktimi i vonesave të
17 panevojshme, të padëshiruar dhe të papërligjura.

18 Shqetësimi që ka ZPS-ja, sa i takon ndikimit në procese
19 të tjera gjyqësore, nuk i përmbush kushtet për certifikim.
20 Aspektin e mbajtur parasysh nga Gjykatësi i Procedurës
21 Paraprake në vendimet e tij të mëparshme, por edhe ato që janë
22 mbajtur parasysh në vendimin e Panelit të Trupi Gjykes në
23 çështjen Thaçi dhe të tjerët, në materialin F172, thuhet se
24 konsideratat që duhen mbajtur parasysh në apelimin e
25 ndërmjetës do të duhej që të trajtonin çështje themelore apo

1 do të duhet që të ishin me përfitim për Dhomat Gjykatëse, por
2 në vetvete këto nuk e përlligjin certifikimin për apel.

3 Prej kohe është bërë e qartë se ZPS-ja i sheh detyrimet
4 për nxjerrje nga ana e saj si një barrë, por rregulli 112 e
5 Rregullores parashikon se këto detyrime të nxjerrjes janë
6 detyrime në vijimësi dhe ZPS-ja nuk mund të mbyllë nxjerrjet
7 në një moment të caktuar.

8 Shqetësimi edhe njëherë, nga ana e ZPS-së si dhe më parë
9 është se ato do të kërkojnë që të përditësojnë njoftimin e
10 rregullit 102(3) sa herë që të marrin informacion të ri është
11 thjeshtë një ankesë për funksionimin e duhur të rregullit
12 102(3), siç është konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës
13 Paraprake, nga Paneli i Gjykatës së Apelit por edhe nga ky
14 Trup Gjykues më parë.

15 Prokuroria thjesht kërkon që t'u shmanget detyrimeve për
16 nxjerrje.

17 Edhe, gjithashtu, përtej kësaj, ne parashtrojmë se i
18 vetmi shkak për vonesë në këtë proces është thjesht
19 mosangazhimi nga ana e ZPS-së për të bërë nxjerrjet e duhura.
20 Ky certifikim duhet të refuzuar në mënyrë që procesi gjyqësor
21 të vijojë edhe më tej.

22 Sa i takon paragrafit 24 dhe prezumimit të lejes për
23 apel, konferenca për përgatitjen e çështjes dhe vendimi që u
24 mor në të nuk ishte një çështje e diskutueshme. Ndërkohë
25 kuptimi i pasojave ishte absolutisht i qartë. ZPS-ja ka

1 përdorur një interpretim të papërshtatshëm të çështjes dhe
2 ZPS-ja kërkohet që të japë njoftim sipas rregulli 102(3).

3 ZPS-ja, në këtë rast u përpoq që të shpifte një çështje
4 përpara këtij Trupi Gjykues për një përfundim të Gjykatës së
5 Apelit vetëm për faktin që ata thjesht nuk ishin dakord me
6 këtë dhe të njëjtën gjë janë përpjekur që ta bëjnë me vendimin
7 për nxjerrje.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,
9 ju lutem përmbylleni.

10 Z. REES: [Përkthim] Në rregull. Atëhere do të doja të
11 thosha që një mundësi e mëtejshme e Gjykatës së Apelit, siç
12 është përshkruar për të qartësuar fushën e veprimit të
13 detyrimeve për nxjerrje në çështjen në fjalë, nuk kërkohet në
14 pjesën e mbetur të këtij gjykimi të shkurtër. Në qoftë se
15 kërkohet apo jo në çështjen në fjalë kjo gjë, është një
16 çështje nga e cila duhet që të nxirren përfundimet mbi bazën e
17 procedimeve të tjera dhe gjykimeve të tjera.

18 Përfundimi është, që prezumimi në paragrafin 26 të
19 kërkesës së ZPS-së gjithmonë ka qenë e drejtpërdrejtë ZPS-ja
20 sa i takon provave në posedim dhe në zotërim të saj. ZPS-ja ka
21 shmangur kërkesat e parashikuara në rregullin 102(3) për të
22 dhënë njoftim për gjithë materialin relevant në zotërim të
23 saj. Në shkallë të parë ose në nivel të parë, duke kërkuar të
24 injorojë kërkesat për ofrimin e një njoftimi për të gjithë.
25 Ndërkohë dispozita dhe ofrimi i njoftimit për 13 dokumente, të

1 cilat Mbrojtja i ka kërkuar me të drejtë, nuk i janë dhënë
2 Mbrojtjes. Kjo kërkesë është një tjetër shembull i përdorimit
3 të qëndrimit të ZPS-së.

4 Trupi Gjykses, në vendimin e vet ka shprehur shqetësime
5 lidhur me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, veçanërisht në
6 paragrafi 48 të vendimit, Trupi Gjykses thotë:

7 "Kuptimi ligjor i ZPS-së në këto procedura e bën Trupin
8 Gjykses të jetë i shqetësuar lidhur me përmbushjen e plotë të
9 ZPS-së të detyrimeve të veta për nxjerrje të informacionit".

10 Kjo kërkesë, sërish, fatkeqësisht e thekson më tepër këtë
11 shqetësim. Ajo duhet të refuzohet. Nxjerrja e dokumenteve
12 duhet të bëhet sipas urdhrit të dhënë dhe Paneli Gjykses duhet
13 të vazhdojë punën e vet normalisht.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

15 Faleminderit, z. Rees.

16 Z. Cadman, fjala për ju.

17 Z. CADMAN: [Përkthim] Unë do të flasë sa më shkurt të
18 jetë e mundur. Do të theksoj disa prej pikave të tjera shtesë
19 që nuk u cekën nga z. Rees.

20 Z. Rees ndërkohë ka dhënë, ka ofruar kuadrin ligjor për
21 certifikimin ose për miratimin, për pranimin dhe kështu që
22 dëgjuam z. Rees që të na shpjegonte elementin e shtytjes në
23 vepër penale të lidhur me ZPS-në. Kështu që nuk do të cek këtë
24 temë gjatë parashtrimit tim. Megjithatë unë do të parashtroj
25 që qartësimi për apel nuk duhet të jepet për kërkesën në

1 fjalë.

2 Pra, aplikimi i ZPS-së në realitet është thjesht një
3 tjetër shembull i mënyrës apo i sjelljes së ZPS-së për ti bërë
4 bisht detyrimeve të saj për nxjerrje të informacionit të cilat
5 ne i kemi parë gjatë gjithë këtij procesi gjyqësor.

6 Është e rëndësishme të vërehet se nxjerrja e
7 informacionit ose mungesa e saj është diçka me të cilën
8 Mbrojtja është hasur dhe është dashur që të cekë që prej
9 fillimit të këtyre procedimeve. Tema të cilën po mbulojmë ne
10 sot nuk është një temë e re është diçka e cila ka dalë herë
11 pas here është ngritur si çështje shqetësuese që prej fillimit
12 në këto procedura ligjore.

13 Sipas pikëpamjes tonë, ZPS-ja është përpjekur që të
14 konfiskojë në çdo pikë, në çdo vonesë të këtyre procedurave
15 dhe siç u parashtrua dhe nga z. Rees dhe në çdo pikë të
16 proceduarave në fjalë, ne jemi hasur me veprimet ose
17 mosveprimet e ZPS-së. Është e paqartë lidhur me bazën
18 thelbësore ose materiale të çështjes që ka qenë përpara
19 Gjykatësit paraprak.

20 Ndërkohë që duhet të kujtohen edhe prova të cilat kanë të
21 bëjnë me pjesën për nxitjen në vepre penale.

22 ZPS-ja në paragrafin 3 të kërkesës së saj, kërkon të
23 sugjerojë që provat janë parashtruar dhe janë justifikuar
24 ndryshimet e vendimit të Gjykatësit të procedurës Paraprake
25 për sa i takon mosmaterialitetit. Z. Reese e ceku këtë

1 çështje.

2 Por unë them që ZPS-ja kërkon që të parashtrojë një
3 argument që tjetërson zbatimin e kuadrit ligjor dhe ka ndikim
4 të drejtpërdrejtë mbi materialitetin e çështjes.

5 Çështja tjetër që u parashtrua nga z. Rees dhe vetëm do
6 të dua të them diçka lidhur me këtë element, pasi siç e thashë
7 ato u trajtuan nga z. Rees, megjithatë: Në parashtrimin tim
8 dua të them që ZPS-ja nuk ka bazë, e ka keqkuptuar dhe nuk ka
9 themel të çështjes. ZPS-ja, pra, është që në fillim me një
10 qasje e cila nuk i shkon për shtat kësaj çështjeje.

11 Nuk ka asgjë që është parashtruar nga ZPS-ja që ka të
12 bëjë me parashtrimin e ZPS-së për çështjen e parë sepse çdo
13 gjë që demonstron prej tyre nuk është në përputhje me atë
14 çfarë është vendosur nga Paneli, nga Trupi Gjykses dhe
15 pozicioni i tyre është jo korrekt, i papranueshëm dhe jo në
16 pajtim me rregullat e procedurës dhe të provave të ZPS-së.

17 Çështja e dytë, e lidhur me ZPS-në është, që ZPS-ja
18 kërkon që të marrë me mend se cili është pozicioni i
19 Mbrojtjes. Ndërkohë z. Rees sërish e ceku këtë çështje në
20 parashtrimin e vet dhe nuk dua ta çoj atë më tej.

21 Sa i takon çështjes së tretë. ZPS-ja ka dështuar të njohë
22 një çështje thelbësore. Ne kemi parashikuar në kërkesën
23 materiale për nxjerrjen e materialeve dhe kemi cituar
24 gjithashtu edhe çështjen Edwards dhe Lewis kundër Mbretërisë
25 së Bashkuar që mbështet pozicionin tonë sa i takon

1 parashtrimin për nxjerrjen e materialeve.

2 Në veçanti, duke iu drejtuar Trupi Gjykues në paragrafët
3 31 deri në 58, në paragrafin 31, thuhet që Prokuroria ka
4 detyrën që të nxjerrë çdo material që ka në posedimin e vet
5 dhe që ka të bëjë me provat që duhet të dijë Mbrojtja, kur
6 Trupi Gjykues, si arbitër i faktit ta ketë parë këtë material,
7 pra, ekziston detyrimi që ky material t'i nxirret Mbrojtjes në
8 mënyrë që të mund të sigurohet drejtësia e proceseve
9 gjyqësore.

10 Është qëndrimi dhe pozicioni ynë që dështimi për të
11 nxjerrë këtë material tani për sa i takon Mbrojtjes ne e
12 mendojmë që një qëndrim i tillë është shkelje e nenit 6(1) të
13 kësaj çështjeje.

14 Atëherë sa i takon çështjes së katërt. ZPS-ja në
15 paragrafin 20 shpreh që vendimi mund të çojë në kërkesa të
16 tjera për nxjerrje të informacionit, proces që ZPS-ja duhet ta
17 marrë në mbikëqyrje të veçantë. Kjo duhet të jetë e dukshme
18 nga ky detyrim.

19 Kur kërkesa të mëtejshme bëhen për nxjerrje, ZPS-ja mund
20 të kërkojë të mos e bëj atë. ZPS-ja mund t'i kërkojë Trupit
21 Gjykues, e mban peng Trupin Gjykues, vetëm në qoftë se bën
22 kërkesa të tilla. Një qëndrim i tillë nuk mund të mbështetet
23 nga Trupi Gjykues. Kjo është ndesh me çdo parim të drejtësisë.

24 Kërkesa duhet hedhur poshtë. Sepse sipas mendimit tonë,
25 nuk është paraqitur asnjë argument dhe e gjithë kërkesa tregon

1 se ZPS-ja nuk bie dakord me vendimin e Trupit Gjykses.

2 Siç ka thënë z. Rees, të japësh leje në këtë moment do
3 t'i vononte dhe më tej procedurat në varësi të çdo apeli.
4 Afati për vazhdimin e këtyre çështjeve është i ngushtë, siç
5 është rënë dakord dhe dhënia e lejes për këtë apel do të
6 shkaktojë padyshim vonesa të konsiderueshëm në këto procedura.

7 Do të doja të përfundoja duke miratuar pjesën tjetër të
8 parashtrimeve të z. Rees. Nuk mendoj se duhet të paraqes diçka
9 tjetër në këtë moment përveçse nëse ju doni të trajtoj diçka
10 të veçantë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

12 Faleminderit, z. Cadman.

13 Z. Halling, keni fjalën.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

15 Gjykatës.

16 Disa pika të përgjithshme kam.

17 Pikë së pari, kjo është diçka që lidhet me certifikimin,
18 me lejimin e një vendimi dhe nuk ka të bëjë me faktin nëse
19 Trupi Gjykses nuk përputhej me kuadrin ligjor apo ishte jo
20 korrekte. Këto janë argumente që do bëhen për thelbin e apelit
21 në qoftë se do të miratohet. Ju dëgjuat shumë parashtrime
22 lidhur me korrektesën e vendimit. Nuk është vendi për leje për
23 të apeluar një kërkesë për t'i thënë këto gjëra. Themeli i
24 apelit përcaktohet më vonë.

25 Ne, padyshim, i kuptojmë rregullat e nxjerrjes si zyrë

1 dhe kemi argumentuar për to. Ka aspektet me të cilat Trupi
2 Gjykues nuk është pajtuar me ne në vendimin e kundërshtuar. Ne
3 kemi kërkuar leje të apelojmë atë vendim dhe nuk e bëjmë që të
4 mos jemi të respektuar apo sepse nuk duam të përmbushim
5 rregullin. Ne do ta respektojmë rregullin. Por na lejohet kjo
6 mënyrë veprimi për të kundërshtuar këtë vendim në apel.

7 Finaliteti i nxjerrjes doli nga parashtrimet e Mbrojtjes.
8 Nxjerrja nuk është përfundimtare si një propozim i
9 përgjithshëm. Ne flasim për nxjerrje, për një lloj materialesh
10 konkrete dhe rruga duhet të jetë e hapur. Dhe finaliteti i
11 kësaj rruge vihet në diskutim këtu.

12 Pra, ne nuk po flasim për diçka, ky është fundi i
13 nxjerrjeve. Dhe nuk ka pse të supozohet kjo nga kërkesa që
14 kemi bërë.

15 Së treti. Çështja themelore nuk duhet të drejtohen nëse
16 duhet apo jo dhënë leja për apel. Kjo është e vërtetë lidhur
17 me çështjet e përgjithshme të cilat nuk duhet të jepen arsyet
18 nëse duhet dhënë leja për apel. Duhet të indeksohet në
19 rrethanat konkrete të çështjes. Po kjo ndryshon nga ajo se
20 çështjet themelore nuk kanë lidhje për të dhënë, për të
21 miratuar një apel të ndërmjetëm.

22 Këto çështje mendojmë që i përmbushin kërkesat për apel.
23 Gjykimi i Panelit të Apelit që është dhënë konfirmon vendimin
24 e Gjykatësit të Procedurës Paraprake sepse arsyet janë të
25 njëjta dhe do të ketë ndikim dhe në çështje të tjera.

1 Për arsyet që ne kemi parashpjeguar në parashtrimin tonë
2 dhe kjo është një arsye plus, shtesë, që duhet marrë parasysh
3 lidhur me përmbushjen e kriterëve.

4 Për sa i takon mospajtimin, përpara se të futemi në arsye
5 dhe argumente konkrete, çdo kërkesë për leje për apel është
6 një mosmarrëveshje në vetvete. Gjuha, thjeshtë gjuha e
7 mospërputhjes lidhur me diçka nëse është apo jo e apelueshme
8 është një vlerësim nëse është një mosmarrëveshje e
9 përgjithshme që mund të mos ketë qenë vendimtare në vendimin
10 apo nuk ka dalë nga vendimi, apo për arsye të ndryshme nuk i
11 përmbush kriteret.

12 Në qoftë se vetëm kërkesat do të ishte justifikim për të
13 hedhur poshtë lejen për ta apeluar, kjo në vetvete, leja për
14 apel, atëherë nuk do të jepej kurrë. Ndryshe vendimi nuk do të
15 kishte asnjë ndikim në palën që bën një kërkesë të tillë.

16 Duke iu kthyer argumenteve të çështjeve të apelueshme që
17 u ngritën nga Mbrojtja.

18 Duke u fokusuar në çështjen e parë dhe nëse çështjet
19 abstrakte futen në lojë këtu, nuk është çështje për mendimin
20 tonë abstrakte. Në paragrafin 53 të vendimit të kundërshtuar
21 Trupi Gjykues paratha se ishte e parakohshme të trajtohej
22 natyra jo e mundshme e mbrojtjes së nxitjes për një vepër
23 penale. Dhe duke e parë mënyrën sesi është zbatuar testi ka
24 gjetje që nuk marrin parasysh potencialin, mundësinë e
25 mbrojtjes së nxitjes për një vepër penale.

1 Për ne ky është thelbi i çështjes. Kemi argumentuar
2 vazhdimisht dhe nuk mund të thuash fjalën "nxitje" për një
3 vepër penale dhe të marrësh nxjerrjen e materialit.

4 Pavarësisht nëse është diçka abstrakte apo diçka që bazohet.

5 E njëjta gjë mund të thuhet dhe për çështjen e dytë. Kur
6 flasim për pamundësinë ligjore dhe faktike, Trupi Gjykses nuk
7 i preku këto çështje dhe ne kemi të drejtë të argumentojmë në
8 një kërkesë për leje për apel, se nga vendimi del dhe është
9 një gabim i mundshëm në atë vendim që duhet zgjidhur në apel.

10 Lidhur me argumentet e Mbrojtjes se nuk ka fare autoritet
11 për propozimin që bëjmë ne në kërkesë lidhur me nxitje,
12 shtytje për vepër penale, unë i tërheq vëmendje Mbrojtjes në
13 paragrafin 47 thuhet kjo:

14 "Është çështja kundër Lituanisë, e diskutuar nga Dhoma e
15 Madhe, thuhet që një punonjës i përfshirë në këtë vepër ka
16 ushtruar një ndikim të tillë sa që do të nxiste kryerjen e një
17 veprë penale e cila ndryshe nuk do të ishte kryer".

18 Dhe ne, po e citojmë këtë, pra, është nga Gjykata e Të
19 Drejtave të Njeriut dhe nga parashtrimet e Mbrojtjes së
20 Haradinajt të cilat janë poshtëshënuar në kërkesën tonë.

21 Ne nuk mendojmë se po bëjmë ndonjë -- po bëjmë argumente
22 agresiv lidhur me përkufizimin e shtytjes për vepër penale.
23 Kjo është plotësisht e pamundur dhe natyra plotësisht e
24 pamundur e shtytjes për vepër penale duhet të përbëjë pjesë të
25 kërkesës për nxjerrje. Trupi Gjykses ka menduar ndryshe. Por

1 për ne tani duhet të vërtetohet nëse duhet të provohet nëse
2 vërtetimi i saj -- kërkohet vërtetimi.

3 Tani kërkesa tjetër lidhur me pragje të reja. Në qoftë
4 se është plotësisht, në qoftë se është e pa provuar apo kjo
5 është një -- në qoftë se dikush nuk provohet si mund të ndodhi
6 që të jetë plotësisht e pamundur. Kjo tregon shumë pragun që
7 Mbrojtja duhet të përmbushë për të justifikuar rëndësinë
8 materiale të përgatitjes së Mbrojtjes. Dhe kjo është çështja
9 që duam të apelojmë në vendim, për të parë nëse ky prag është
10 i mjaftueshëm për të justifikuar nxjerrjen.

11 Për çështjen e katërt. Kalimi i masave hipotetike,
12 kundërmaset pra. Ne nuk po argumentojmë në asnjë mënyrë se
13 Trupi Gjykses nuk mund të tejkaloj masat kundërbalancuese të
14 ZPS-së. Sigurisht, Trupi Gjykses lejohet të vlerësojë
15 propozimet kundërbalancuese por puna është sesi i janë
16 tejkalluar dhe kjo është baza ku ne e kemi paraqitur kërkesën
17 tonë.

18 Mbrojtja argumenton se ZPS-ja nuk mund ta përjashtojë
19 mundësin e shtysës për veprë penale, prandaj po reziston
20 nxjerrjen e materialit. Problemi që ne kemi pasur është që
21 Mbrojtja na kërkon të provojmë një nxjerrje negative, një
22 deduksion negativë bazuar në asgjë. Kjo është jashtëzakonisht
23 e vështirë ta bësh. Si të përpiqesh të mos thuash se ka
24 fantazma në dhomë. Është shumë vështirë të paraqesësh
25 informacion dhe në nivel nxjerrjeje për të provuar që kjo nuk

1 ndodhur. Pra, kjo është lufta që ne kemi pasur gjatë gjithë
2 kohës dhe për vlerësimin tonë nuk është kjo mënyra e duhur për
3 të vlerësuar rëndësinë materiale të përgatitjes së Mbrojtjes
4 po të shohim faktet dhe rrethanat e çështjes.

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dhe pesë minuta.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Pika e fundit që doja të trajtoja
7 ka të bëjë me efektin pezullues.

8 Në disa kërkesa për efekt pezullus është lënë mënjane si
9 të thuash për shkak të vendimit që do të japë Trupi Gjykses.
10 Në qoftë se miratohet efekti pezullues do të miratohet në
11 vendimin certifikues.

12 Dua të theksoj argumentet e Haradinaj se kjo do të
13 pezullojë gjyqin derisa të dëgjohej apeli. Nuk ka arsye sepse
14 gjyqi duhet të pezullohet për të dëgjuar një apel të
15 ndërmjetëm për këto çështje.

16 Trupi Gjykses ka bërë konstatime të mëparshme se këto
17 çështje të nxjerrjes mund të lihen për më vonë në varësi të
18 paraqitjes së provave. Vetë vendimi i kundërshtuar e
19 parashikon këtë si një masë pasi të jepet, të nxirren
20 materiale të tjera.

21 Dallimi midis shtyrjes për një muaj apo dy sa të dali
22 vendimi i apelit të ndërmjetëm, nuk ka sepse ta pezullojë apo
23 pengojë ecurinë e gjyqit. Duke pasur parasysh rëndësinë e
24 çështjes, fakti që është dhënë një vendim i Trupit të Apelit
25 që duket se kërkon zhvillim të mëtejshëm në apel, por këto

1 çështje nuk janë finale, nuk janë të zgjidhura, mendojmë se
2 këto justifikojnë dërgimin e çështjes për një apel tjetër.

3 Ne nuk e kemi kërkuar ta bëjmë dhe nuk është e nevojshme.
4 Kjo do të ndodhë paralel me gjykimin. Ne kërkojmë vetëm të mos
5 të pezullohet, domethënë, nxjerrja shtesë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

7 Faleminderit, z. Halling.

8 Ka pyetje.

9 Z. Gaynor.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë.

11 Pyetjet që kam unë janë për ZPS-në.

12 Pyetja e parë ka të bëj me masën deri ku ju si zyrë
13 kundërshtoni vendimin e kundërshtuar. Është e qartë se ju nuk
14 e kundërshtoni të gjithë. Kolegu juaj, z. Pace, kërkoi efektin
15 pezullues lidhur me paragrafi 95(b).

16 Dua të sqaroj me ju, pasi kam lexuar kërkesën tuaj për
17 certifikim, kundërshtoni për nxjerrjen e asaj që përshkruhet
18 si fragmente të dokumentit 191 siç parashikohet në vendimin
19 strickly [fonetikisht] konfidencial dhe *ex parte*?

20 Z. HALLING: [Përkthim] Po.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kundërshtoni juve për
22 nxjerrjen e përmbledhjes së verifikimeve lidhur dokumentin
23 195, 200?

24 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Ne i paraqitëm masat
25 kundërbalancuese si paketë për të përmbushur kërkesën

1 alternative që ato duheshin miratuar në bllok. Trupi Gjykses
2 nuk e bëri këtë. Prandaj neve kërkua që masat
3 kundërbalancuese të miratoheshin të gjitha.

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kundërshtoni urdhrin e
5 Panelit për ZPS-në që të zbatohet masat e propozuara të lidhura
6 me dokumentin 201 dhe të raportonte përpara Trupit Gjykses
7 deri në 12 nëntor?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, sepse nuk jepet, nuk është
9 urdhëruar nxjerrje tjetër. Me sa dimë neve është shtyrë por
10 nuk ka ndonjë çështje konkrete për të kërkuar apel.

11 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, vendimi që kërkoni
12 certifikim është vendimi për të nxjerrë shtojcën *ex parte* të
13 vendimit të kundërshtuar numër një dhe përmbledhjen e
14 verifikimeve numër dy?

15 Z. HALLING: [Përkthim] Kërkojmë leje për të apeluar këto
16 gjëra. Sepse siç mund ta imagjinoni, do ta kundërshtojmë idenë
17 sepse kjo leja për apel ka të bëjë vetëm me dallimet midis
18 masave kundërbalancuese të propozuara.

19 Është një rrugë që hapet apo mbyllet si rezultat i kësaj,
20 ka çështje që i tejkalojnë dallimet midis propozimeve
21 kundërbalancuese.

22 Ka pasoja të tanishme dhe të ardhshme.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju doni të certifikoni
24 një vendim dhe unë po përpigën të sqaroj se çfarë konkretisht.

25 Pra, në kërkesën për certifikim në paragrafin 21 [sipas

1 përkthimit], thoni dhe citoj:

2 "Se ZPS-ja ka argumentuar se nxjerrja në fjalë kërcënon
3 mandatin e vet".

4 Me këtë doni të thoni se vendimi i Panelit për të
5 urdhëruar nxjerrjen e këtyre dy dokumenteve që thashë - siç
6 është versioni i redaktuar i 191 dhe përmbledhja e
7 verifikimeve - ato kërcënojnë mandatin e ZPS-së po thoni?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po të ishin vetëm këto faqe dhe
9 asgjë tjetër, mund të kishim argumentuar ndryshe. Por nuk
10 është ky fushëveprimi i vendimit të kundërshtuar. Ju bëtë një
11 konstatim të përgjithshëm për rëndësinë materiale të këtij
12 lloj informacioni lidhur me provat që ka dhënë Mbrojtja dhe
13 fushëveprimi në bazë të këtij vendimi është pjesë përbërëse e
14 vendimit dhe pjesë e kriterëve të lejes për apel.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po ju pranoni se vetë
16 vendimi është shumë i kufizuar për sa i takon paragrafit 95,
17 sepse ajo është e qartë sepse urdhërohet nxjerrja në bazë të
18 paragrafit 95?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Nxjerrja [sipas përkthimit]
20 nxirret si bazë. Po përpara kësaj duhet të gjejë, duhet të
21 përcaktojë nëse kishte material që ka pasoja që kalojnë ato
22 masat kundërbalancuese.

23 Paragrafi 95 ka disa konsiderata ligjore që ndikojnë, për
24 mendimin tonë, në rëndësinë e vendimit dhe lejen për të
25 apeluar.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do të kalojmë tek paragrafi
2 14 i certifikimit tuaj për apel dhe ju thoni:

3 "ZPS-ja ka parasysh se natyra tërësore e shtysës për
4 veprë penale duhet trajtuar ndryshe kur diskutohet nxjerrja e
5 materialeve".

6 Dua të përqendrohem te fjala, "natyra e pamundur shtyrjes
7 për veprë penale". Në çfarë baze kërkoni ju që ta bëjmë ne, si
8 Trupi Gjykses, këtë vlerësim?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Përgjigja do të ishte tërësia e
10 provave të paraqitura në këtë çështje, nuk do ta klasifikonim
11 sipas llojit. Po nëse është tërësisht e pamundur do të
12 mbështetej tek një vlerësim tërësor i të gjithë provave të
13 paraqitura.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe a është relevante nëse
15 ZPS-ja ka bërë hapa për të përjashtuar përfshirjen e stafit të
16 vet në nxjerrjen apo në dorëzimin e këtij informacioni zyrove
17 të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Do thosha jo, po mbi faktet e
19 kësaj çështjeje. Unë nuk do të thosha kurrë, kurrë se metodat
20 hetimore të ZPS-së do të ishin një -- që do t'i shpërbënin
21 çështjet në gjykim do të kërkonin nxjerrje për t'u trajtuar në
22 bazë të provave.

23 Në këtë proces gjyqësor nuk ka informacion të mjaftueshëm
24 që justifikon nxjerrjen nga ana jonë që nuk përmbush pragun e
25 materialitetit për përgatitjen e Mbrojtjes, pra, nuk do të

1 justifikonte këtë nxjerrje.

2 Por, nëse do të bënim një vlerësim të fakteve në këtë
3 çështje qoftë edhe në vlerësim *prima facie* nuk do të ishte
4 materiale.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nëse do të bënim një
6 vlerësim specifik të fakteve, të provave që kanë të bëjnë me
7 shtytjen në krim, a mendoni se ky vlerësim do të mbështetej
8 tek procedura ballafaqese për të marrë një vendim lidhur me
9 këtë?

10 Z. HALLING: [Përkthim] Po, sigurisht. Patjetër që po. E
11 vetmja gjë që do thosha për këtë është, se atë që po kërkon i
12 nderuar Gjykatës, apo po pyet ka të bëjë me themelin e
13 vendimit të kundërshtuar.

14 Pra, ne nuk kemi argumentuar në kërkesën tonë që Trupi
15 Gjykues ka bërë gabime të ligjit apo ka shkuar përtej
16 diskrecionit të vet. Ne do të shihnim se cilat janë interesat
17 që vendosen në drejtpeshim.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dua të kaloj në paragrafin
19 24 [sipas përkthimit] të kërkesës tuaj ku ju thoni, ju citoj:

20 "Nëse Trupi Gjykues do ta kishte nënshtruar pretendimeve
21 të shtytjes në krim ndonjë shqyrtimi, siç janë zhvilluar në
22 bazë të çështjeve të tjera, masat kompensuese të ZPS-së nuk do
23 të kishin [qenë] tejkaluar".

24 Pyetja e parë që kam është kjo: A është detyra e Trupi
25 Gjykues apo e ZPS-së, apo e të dyve që t'ia nënshtrojnë

1 pretendimet për shtytjen në krim shqyrtimit?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Është një pyetje interesante.

3 Përgjigja ime do të ishte se të gjithë kanë një farë detyrimi
4 në kuadër të nxjerrjes që të angazhohen me mundësinë
5 prospektive të pistës së Mbrojtjes për shtytjen në krim kur
6 jepet një urdhër lidhur me këtë.

7 Të paktën duhet që të ketë, pra, nga ana e Mbrojtjes
8 duhet të ketë të paktën një provë *prima facie*. Po kështu edhe
9 Prokuroria ka dhe barrën e vet për të thënë që nuk përmbushet
10 kjo *prima facie*. Ndërkohë që Trupi Gjykues, sigurisht, që ka
11 anën e vet të përgjegjësisë për të marrë një vendim, pra, për
12 të bërë konstatim.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Halling, gjatë
14 vlerësimit të pretendimeve për shtytjen në krim, siç sugjeroni
15 ju, nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e
16 Njeriut duket se peshorja anon shumë tek dëgjimi i argumenteve
17 ballafaqese për materialin në fjalë.

18 A nuk do të ishte e saktë nëse do të thoshim që Trupi
19 Gjykues mund të dëgjojë argumente ballafaqese.

20 Po e filloj edhe njëherë.

21 A është e saktë që Trupi Gjykues mund të dëgjojë vetëm
22 argumente ballafaqese -- nëse mund të dëgjohem tani.

23 Edhe njëherë z. Halling.

24 Si mundet Trupi Gjykues që të dëgjojë argumente
25 ballafaqese për këtë material nëse ZPS-ja nuk ia paraqet këto

1 Mbrojtjes, nuk ja nxjerrë, pra, Mbrojtjes?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Siç e kuptojmë ne këtë pyetje kjo
3 varet nga pragu i nxjerrjes që përmbushet. Ne nuk kemi
4 kundërshtim që të ketë argumente ballafaqese nëse përmbushet
5 pragu *prima facie*. Por rrjedhojat e pyetjes suaj është që pa
6 pasur asnjë bazë Mbrojtja mund të thotë mjafton vetëm frazën
7 "shtytje në krim" dhe menjëherë futet në lojë nxjerrja për
8 argumente ballafaqese edhe në ato raste kur nuk përmbushet
9 pragu *prima facie*.

10 Ky është një argument pritës të themi. Sepse herës tjetër
11 pastaj mund të themi "ou duam të gjitha provat që ZPS-ja mund
12 të ketë ushtruar influencë të paligjshme ndaj dëshmitarëve. Ne
13 nuk kemi prova për këtë po le të na e nxjerrë materialin ZPS-
14 ja për këtë. Ne thjesht i duam të gjithë informacionet".

15 Seancat ballafaqese kanë kufizimet e tyre. Kuadri i
16 nxjerrjes në këtë Gjykatë vendos kufizime mbi nxjerrjen. Se
17 nuk është një nxjerrje me libër të hapur, me portë të hapur,
18 që çdo gjë i jepet Mbrojtjes.

19 Ne argumentojmë që, sigurisht, që duhet vlerësuar në
20 mënyrë ballafaqese. Por është që duhet të përmbushet pragu
21 bazë *prima facie* në mënyrë që ta kemi këtë bashkëbisedim
22 ballafaques për nivelin e nxjerrjes që duhet përmbushur.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Do ta mbyll me një gjë të
24 fundit. Mund të më korrigjoni nëse e kam gabim.

25 Por nga kërkesa juaj për certifikim, ne nuk shohim se ju

1 tregoni ndonjë fjali të caktuar në versionin e redaktuar të
2 pikës 199 [sipas përkthimit], materialet 199 [sipas
3 përkthimit] që është bashkëlidhur si shtojcë *ex parte* e
4 vendimit të kundërshtuar dhe nuk citoni asnjë fjali në
5 përmbledhjen e cila do ta cenonte në mënyrë katastrofike ZPS-
6 në qoftë në këtë hetim apo qoftë edhe në hetime të tjera nëse
7 do të kishte lidhje me to.

8 Mua kjo më duket shumë e rëndësishme sepse nuk keni
9 identifikuar me konkretësi qoftë edhe një fjalë të vetme.

10 Ju kërkoj mendimet tuaja lidhur me këtë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Keni të drejtë dhe unë menjëherë
12 e pashë kërkesën tani. Por edhe njëherë dua të them se kjo ka
13 të bëj me thelbin e kësaj kërkesë, ka të bëjë me masat
14 kompensuese.

15 Ne kemi argumentuar gjithmonë se ka pasoja shumë të mëdha
16 për nxjerrje të mundshme, për zyrën tonë dhe për zhvillimet
17 hetimore që mund të lindin në çdo moment në një sërë temash të
18 caktuara që mund të bëhen të nxjerrshme për shkak të këtij
19 vendimi. Kjo është hera e parë që nuk është më abstrakte, nuk
20 është hipotetike, është një nxjerrje që do të duhet të bëhej
21 konkretisht.

22 Prandaj i kërkojmë Trupit Gjykses që të mbajë parasysh
23 pasojat e plota të vendimit të kundërshtuar. Nuk është vetëm
24 dallimi midis dy qëndrimeve propozimi i ZPS-së dhe urdhri i
25 Trupit Gjykses. Janë parimet themelore mbi të cilat bazohet

1 vendimi procedural për këtë çështje por edhe për çështje tjera
2 gjyqësore.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, z. Halling.

4 Faleminderit, z. Kryetar i Trupit Gjykses.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
6 Mettraux ka disa pyetje.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës
8 Smith.

9 Vargu i parë i pyetjeve që kam unë me shumë gjasë i
10 drejtohet juve, z. Halling, por ka të bëjë me çështjen e parë
11 që ju kërkoni leje për apelim. Do lexoj paragrafin 2 të
12 parashtrimit tuaj. Është:

13 "Nëse, në aspektin juridik, një vlerësim i rëndësisë
14 materiale për përgatitjen e Mbrojtjes mund të bëhet në mënyrë
15 abstrakte apo nëse kërkon vlerësimin e rëndësisë materiale në
16 lidhje me faktet dhe rrethanat e çështjes gjyqësore".

17 Dua që ta shtjelloj këtë paksa me të dyja palët. Por
18 përpara kësaj dua që t'i jap një historik Mbrojtjes në mënyrë
19 që t'i përgjigjeni pyetjes në mënyrë efektive.

20 Gjatë seancës *ex parte* që kemi bërë me ZPS-në, Trupi
21 Gjykses i rikujtoi në mënyrë të përsëritur ZPS-së, nevojën për
22 një nivel të arritur drejtësie për shkak të faktit se Mbrojtja
23 nuk po merrte pjesë në atë seancë. Trupi Gjykses i kërkoi ZPS-
24 së në mënyrë të kërkuar që t'i fokusonte parashtrimet e veta
25 lidhur me atë se çfarë do të duhej të vendoste ky Trup Gjykses

1 dhe jo mbi një apelim të mundshëm në të ardhmen të cilën ZPS-
2 ja në mënyrë të përsëritur e ka cekur si një mundësi.

3 ZPS-së iu kërkua tre herë që të identifikojë ndonjë fjali
4 apo pjesë në lidhje me të cilën kundërshtohet nxjerrja. ZPS-ja
5 nuk pranoi që të përfshihej në një proces të tillë dhe unë vë
6 re, z. Halling, që edhe sot ju nuk u angazhuat edhe në
7 përgjigjet e pyetjeve që bëri Gjykatësi Gaynor.

8 Z. Halling: A e pranoni se sipas rregullit 102(3) barra e
9 konstatimit të mosqenit me rëndësi materiale të këtij
10 materiali ju takon juve, domethënë, ZPS-së. A e pranoni këtë?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Sipas rregullit 102(3), ne jemi të
12 detyruar që ta kundërshtojmë rëndësinë materiale kur
13 përzgjidhet një material. Ne nuk jemi dakord me konkluzionin e
14 Trupit Gjykses që kjo do të thotë që rëndësia materiale për
15 përgatitjen e Mbrojtjes ka një kuptim tjetër në këtë Gjykatë
16 në dallim nga Gjykatat e tjera.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju ndaloj këtu. Dua
18 që të jeni sa më i fokusuar për pyetjen time. A e pranoni që
19 keni barrën e konstatimit të mosrëndësisë materiale? Mos hyni
20 tek testi. A e pranoni apo jo që barra ju takon juve, sipas
21 102(3) që të konstatoni se materiali që kërkohet të nxirret
22 nuk është me rëndësi materiale?

23 Z. HALLING: [Përkthim] Po, duhet që ne të mbështesim
24 kundërshtimin tonë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë pra. A mund të na

1 thoni se ku e keni përmbushur këtë barrë lidhur me materialin
2 për të cilin nuk pranoni që ta nxirrni? Ju lutem, të jeni sa
3 më specifik.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Dua që të sigurohem a e kam
5 kuptuar qartë. Ku tregojmë ne që ky material nuk është me
6 rëndësi materiale?

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Në kundërshtimin e parë që kemi
9 bërë, është materiali F316, pra, parashtrimi i protokolluar
10 316 ku janë të gjitha argumentet për rëndësinë materiale. Ky
11 është parashtrimi ynë. I cili pastaj është zgjidhur në
12 vendimin e kundërshtuar. Pra, është në dokumentacion kjo gjë.

13 Besoj në të njëjtin protokollim, parashtrim të
14 protokolluar, ne përmendim se cilat pjesë të raportit do të
15 përbënin shqetësim nëse do të nxirreshin.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Atëherë të lexoj nga
17 dokumentacioni. Në seancën *ex parte* të 21 tetor 2021 s'ka
18 asgjë konfidenciale këtu. Tek kjo që do lexoj. Është në faqen
19 1284, unë pyes z. Whiting:

20 "Çështja është nëse ka apo jo informacion këtu", pra, në
21 këtë akt-ekspertizë kriminalistike "nëse përbën shqetësim, siç
22 e përmendi edhe Gjykatësi Gaynor, e cila, nëse do të ishte e
23 nevojshme apo profesionale një nxjerrje e tillë. Në veçanti,
24 nëse kjo pjesë e raportit duket me interes të mundshëm dhe për
25 këtë arsye mund të ketë një rëndësi të mundshme atëherë për

1 Mbrojtjen".

2 Tani përgjigja e z. Whiting, po e parafratoj është që, në
3 thelb, pra, është se i gjithë raporti nuk duhet nxjerrë.

4 Tani edhe njëherë dua që të pyes, kërkoj shpjegim nga ju,
5 cilat pjesë -- për cilat pjesë të raportit ju rezistoni
6 nxjerrjen pra, nuk doni që të bëni nxjerrjen. Ku ta gjejmë që,
7 ku ta kuptojmë ne se ju e keni përmbushur barrën tuaj?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon barrës për çështjet
9 përkatëse është në parashtrimin e protokolluar 389. Aty ka një
10 sërë pikash lidhur me raportet të cilat ne mendojmë se na i
11 cenojnë hetimet tona po nxirreshin.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, ju kërkoj
13 ndjesë. Nuk po ju pyesim për pasojat për hetimet tuaja. Ju
14 pyes për rëndësinë materiale. Janë dy gjëra të ndryshme. Diçka
15 mund të jetë me rëndësi materiale por sigurisht mund të ketë
16 pasoja për hetimet tuaja dhe kjo është një çështje tjetër.

17 Ajo që më intereson tani, para se të kalojmë tek ai
18 aspekt, është që ku ta shikojmë ne përmbushjen e barrës tuaj?
19 Ku ta kërkojmë, pra, që ju e keni përmbushur barrën tuaj për
20 të thënë që ky materiali në fjalë nuk ka rëndësi materiale?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Këto dy, parashtrimi i
22 protokolluar 316 dhe 389, e kanë tërësinë e parashtrimeve
23 tona.

24 Por në përgjigje të pyetjes është që ZPS-ja ka barrën
25 ekskluzive për rëndësinë materiale dhe mbase ky është dhe

1 mospajtimi që ka çuar në këtë kërkesë për -- është që Mbrojtja
2 e ka barrën për të konstatuar rëndësinë materiale.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do flas edhe me
4 Mbrojtjen, po më përpara kësaj unë dua që t'i bëj të njëjtën
5 pyetje Mbrojtjes, po jua bëj dhe juve. Si mund të prisni ju
6 nga Mbrojtja që të konstatojë rëndësi materiale për materiale
7 të cilat ato s'i kanë parë? A duhet të merren me mend apo ka
8 ndonjë mënyrë tjetër sesi mund ta bëjnë ata këtë?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk është nevoja ta marrin me
10 mend. Mënyra sesi janë zhvilluar këto çështje që bazohen tek
11 shtytja në krim në GJEDNJ është që ka disa tregues, disa
12 indicie, të cilat të akuzuarit duhet t'i kenë sepse janë ata
13 të cilët janë kontaktuar dhe mund të jenë influencuar në
14 përgjithësi në çështje të tilla.

15 Por një indicie të tillë ne në çështjen tonë që kemi këtu
16 nuk ka.

17 Prandaj dhe ne duhet t'i përgjigjeshim kësaj nëse ata do
18 të paraqisnin prova *prima facie* për nxjerrjen, atëherë ne mund
19 ta bënim nxjerrjen. Por ata që në fazën e parë, që në tezën e
20 parë nuk e përmbushin dot.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] T'i kthehem pyetjes time.
22 Pra, si mund të prisni ju që Mbrojtja të konstatojë se, të
23 vërtetojë pra, që ka rëndësi materiale për një material të
24 cilin ju nuk ja keni nxjerrë dhe ato s'e kanë parë materialin?

25 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të prezantojmë pistën e

1 Mbrojtjes. Mund të bëjnë pyetje dëshmitarëve të Prokurorisë.
2 Dhe nëse del ndonjë informacion lidhur me nxjerrjen e
3 materialeve të lidhura me pretendimin për shtytje në krim
4 atëherë ne mund ta nxjerrim. Por nëse nuk ka indicie për këtë,
5 si mund të jetë kjo me rëndësi për Mbrojtjen, për përgatitjen
6 e Mbrojtjes, pra, për të -- një pretendim i mbështetur në
7 asgjë.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Doni t'i përgjigjeni
9 kësaj. Do t'ju bëj një pyetje tjetër pas pak, pra, doni të
10 flisni njëherë për rëndësinë materiale të këtij materiali; dua
11 që të di nëse, sipas mendimit tuaj, juve jeni apo jo në
12 gjendje që të bëni një konstatim dhe parashtrim efektiv lidhur
13 me këtë aspekt sa i takon informacionit që keni?

14 Z. REES: [Përkthim] Ne jemi të vetëdijshëm, kemi bërë
15 parashtrime më përpara, sa i takon shqetësimit tonë, sa i
16 takon seancave *ex parte* që zhvillohen. Ne e dimë që
17 parashikohet në Rregullore por edhe sipas bazës evropiane, kjo
18 i përbën pengesa Mbrojtjes në rrethana të tilla. Unë i jam
19 mirënjohës juve i nderuar Gjykatës për informacionet që na
20 dhatë sa i takon se deri ku janë bërë pyetje Prokurorisë. I
21 është kërkuar Prokurorisë më saktë që të mos jetë abstrakte në
22 seancën *ex parte* dhe që i është kërkuar Prokurorisë që të
23 merret me rreth faktet dhe rrethanat e kësaj çështjeje.

24 Ne kishim dyshuar këtë gjë, sepse e kemi parë nga vendimi
25 i Trupit Gjykses që e bënë të qartë pra dhe bie ndesh me ato

1 që parashtrohen në paragrafi 2 të kërkesës nga ZPS-ja sa i
2 takon edhe vlerësimin të funksionimit të rregullit 102(3), 103
3 dhe 108, në bazë të fakteve dhe rrethanave të kësaj çështje
4 gjyqësore duke pasur ato parasysh pra dhe jo duke i zbatuar në
5 abstrakte.

6 I vetmi informacion tjetër që kemi t'i tregojmë Trupit
7 Gjykues në bazë të rëndësisë materiale është vetë vendimi, një
8 vendim i cili përmban konstatimin se ka pasur material në
9 zotërim të ZPS-së që mund të pretendohet se sugjeron se ZPS-ja
10 nuk mund ta përjashtojë mundësinë e shtytjes në krim. Ky është
11 një konstatim në bazë të provave, dëshmive që i është
12 paraqitur Trupit Gjykues gjatë seancës *ex parte* të cilat
13 Mbrojtja nuk i ka. Dhe është një konstatim, i cili me sa duket
14 nuk kundërshtohet nga kërkesa e ZPS-së dhe nuk kundërshtohet
15 gojarisht as nga z. Halling në parashtrimet e tij sot.

16 Ky është një indicie e qartë se ka material që është me
17 rëndësi materiale për përgatitjen e Mbrojtjes dhe për të cilin
18 duhet dhënë urdhër që të nxirret, pra, që duhet nxjerrë në
19 përputhje me vendimin mbi kundërshtimet që ka Prokuroria për
20 nxjerrjen e materialeve të parashtruara në njoftimin e
21 rregullit 102(3).

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Asgjë më shumë për të shtuar
24 thjesht për të mbështetur atë që tha Avokati Rees. Trupi
25 Gjykues tashmë ka konstatuar se mund të ketë një material të

1 tillë Prokuroria, që mund të jetë me rëndësi për Mbrojtjen.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Halling, druaj se kam
3 pyetje të tjera për ju.

4 Z. Rees, po sugjeron se parashtrimet tuaja nuk e
5 përmendin bazën e parashtrimeve tuaja. Dua që të mendoni nga
6 aspekti juridik prej disa prej këtyre aspekteve nëse mund të
7 na ndihmoni apo jo.

8 A jeni në dijeni të ndonjë precedenti ku urdhri për
9 nxjerrjen ka qenë objekt i një leje për apelim e cila është
10 shfrytëzuar pastaj? A jeni në dijeni të ndonjë precedenti të
11 tillë?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk më vjen tani për tani ndonjë
13 në mendje. Në fakt, nëse më kujtohet Banda and Jerbo, vendimi
14 në Banda and Jerbo, ka qenë një apelim i Prokurorisë që ka
15 qenë miratuar me leje për apelim. Nuk jam tërësisht i sigurtë.
16 Se po përpiqem që të mendoj që, sigurisht, që në përgjithësi
17 është Mbrojtja ajo që kërkon leje për apelim. Por nuk ka arsye
18 përse testimi të mos përmbushet kur edhe Prokuroria kërkon
19 leje për apelim për për apelim të një urdhri për nxjerrjen.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirë. Faleminderit. Do
21 t'i kthehem edhe kësaj.

22 Diçka tjetër që dua ta shohim bashkë. Sugjerimi që është
23 bërë në disa pjesë të parashtrimeve tuaja, ato me shkrim por
24 edhe ato të bëra gojarisht sot, se nëse Trupi Gjykses duhet të
25 vendos ta japë apo jo lejen për apelim, duhet që të marrë në

1 konsideratë edhe aspekte të jashtme, procedura të tjera,
2 mandatin e ZPS-së në përgjithësi, çështje gjyqësore të
3 ardhshme e tjerë. Keni ju ndonjë bazë për këtë parashtrim,
4 pra, nëse leja për apelim duhet që të marrë parasysh edhe
5 aspekte të cilat nuk janë të brendshme të procedurës gjyqësore
6 që kemi përpara? Keni ndonjë precedent që ju vjen në mendja?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Për këtë duhet të them që leja e
8 parë për apelim në Gjykatën Penale Ndërkombëtare ka qenë ICC-
9 02-04-01-05, 20 pastaj EXP. Është riklasifikuar në gusht të
10 vitit 2005, 19 gusht.

11 Pra, në paragrafi 54 aty nuk është se flet për efektin në
12 procedurat e ardhshme por duhet pasur parasysh si një
13 argument.

14 Në fakt, është parashtrim prej kohësh edhe Mbrojtja e z.
15 Gucati e ka përmendur si bazë, pra, në vetvete nuk e përlligj
16 certifikimin.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju falënderoj për
18 sinqeritetin në këtë aspekt. Pra, a e pranoni standardin që
19 testi duhet përmbushur në lidhje me aspektin në fjalë ndërkohë
20 që duhet mbajtur parasysh fakti që aspektet e jashtme mund të
21 anojnë nga njëra anë po dhe nga ana tjetër.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Kështu është.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua t'ju pyes edhe
24 njëherë jeni në dijeni të ndonjë precedenti kur leja për
25 apelim është dhënë, pra, është miratuar, në kuadër të një

1 procesi *ex parte*, ku baza mbi të cilën është marrë vendimi ka
2 ardhur në mënyrë *ex parte* në përgjithësi.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Kjo ndodh shumë. Kur ka situata
4 apo kur apelimi kundër një vendimi p.sh., për një kërkesë për
5 fletëarrestim, ta zëmë, p.sh., është një vendim në Gjykatën
6 Penale Ndërkombëtare apo edhe për kompetencën e Gjykatës. Të
7 gjitha këto janë faktikisht në procedura *ex parte*.

8 Ka disa apelime të cilat mund të jenë konfidenciale në
9 dokumentacionin e këtyre institucioneve kur ka seanca *ex*
10 *parte*, po këto janë vetëm disa shembuj në dokumentacionin
11 publik janë këto që thashë unë.

12 Sa i takon ato të kompetencës mund të jetë edhe apelimi
13 po për vendime, pra, bëhet apelimi direkt. Për të tjerat
14 kërkohet leje për apelim.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Arsyeja pse ju pyeta
16 është që të kuptojmë, pra, nëse apelimi në këtë rast do të
17 zhvillojë apo jo, nëse do të miratojë kërkesa për leje për
18 apelim. Në veçanti ju do të kundërshtonit p.sh., që
19 transkripti i seancës *ex parte* t'i vihej në dispozicion
20 Mbrojtjes apo jo?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Çështja nëse transkripti i seancës
22 *ex parte* duhet të jepet Mbrojtjes apo jo, nuk ka lidhje
23 drejtpërdrejtë me lejen për apelim. Po nëse ju do të vendosnit
24 që ta bënit këtë gjë, do kërkonim që të na jepet mundësia që
25 të bëheshin redaktime.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mbase është e ditur po
2 nëse kërkesa për leje për apelim do të miratohej duhej që edhe
3 Mbrojtja të merrte pjesë në këtë proces?

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, sigurisht, nëse propozohet që
5 ky transkript t'i vihet në dispozicion Mbrojtjes me redakte,
6 ne nuk kemi kundërshtim që të vihej në dispozicion nëse do të
7 kishim edhe lejen për apelim.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do të duhet që të bëj
9 disa pyetje lidhur me GJEDNJ-në pas pak.

10 Por si një pyetje paraprake: A e kam kuptuar saktë
11 parashtrim tuaj se ju po i kërkonit Trupit Gjykues në këtë
12 pikë, në këtë etapë, pra, që të konstatojë se pretendimi për
13 shtytje në krim që pretendohet nga Mbrojtja është i fantazuar
14 - është fjala juaj kjo - dhe se nxjerrja e materialit për
15 këtë arsye duhet të mos miratohet?

16 Ju kam kuptuar saktë në këtë parashtrim?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Madje më tej do thosha që ne
18 e dimë që Trupi Gjykues nuk ka të njëjtin mendim. Edhe, siç
19 kemi parë nga vendimi i kundërshtuar. Prandaj në kërkesën tonë
20 është që ky konstatim që ju keni bërë kërkon një apelim
21 ballafaques.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ta supozojmë se e keni
23 të saktë. Nuk po i kthehem pyetjes që ju bëri pyetjes që ju
24 bëri Gjykatësi Gaynor. Çfarë provash do të thoshit ju duhet të
25 mbajë parasysh Trupi Gjykues për të parë nëse ky pretendim për

1 shtytjen në krim është i fantazuar.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Do të jap një përgjigje që i
3 dhashë dhe Gjykatësit Gaynor po në një formë tjetër. Në këtë
4 rast ne nuk kemi kërkuar që të apelojmë konstatime se ky lloj
5 informacioni do të duhej që të ishte i përfshirë në njoftim
6 dhe t'i vihej në dispozicion Trupit Gjykues për konstatimin
7 për nxjerrjen, për vendimin për nxjerrje. Ne thjeshtë kërkojmë
8 apelim tani sa i takon dhënies së informacionit për Mbrojtjen.
9 Trupi Gjykues, sigurisht, gjithmonë do të duhej të ishte në
10 gjendje që të konstatonte nëse një pretendim për shtytjen në
11 krim është apo jo i mundur në bazë të tërësisë së provave që
12 paraqiten në këtë çështje gjyqësore.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ky është konstatim që na
14 kërkohet ta bëjmë përpara se të parashtrojë provat Mbrojtja.

15 Por Mbrojtja ka parashtruar 13 indicie apo për rrethana
16 të cilat ata mendojnë, pra, Mbrojtja mendon se kanë rëndësi me
17 këtë prag. Pra, rrjedhimisht, ju sugjeroni që këto pika janë
18 të pamjaftueshme apo janë vërtetuar në të kundërtën që nuk
19 qëndrojnë pra. Për të përmbushur kështu standardin se është
20 tërësisht jo i mundur.

21 Kështu është parashtrimi juaj?

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Në tërësi
23 ne i kemi diskutuar për këto pika, për këto 13 pika, po nëse
24 dëshironi mund t'i marr me radhë, një për një, por edhe në
25 tërësi ato, pra, së bashku nuk e përmbushin pragun e

1 mundësisë.

2 [Anëtarët e Trupi Gjykses këshillohen]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Që ta
4 dini të gjithë, do të përpiqemi që të mbarojmë këtë çështje
5 pastaj do të bëjmë pushimin.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Desha që t'u jepja rastin
7 të komentoni për diçka z. Halling. Ka të bëjë me sugjerimin
8 që ne po ju ftojme të bëni, një konstatim në këtë fazë lidhur
9 me standardin e shtysës për një vepre penale. Është çështja
10 Bannikova versus Russsia. Paragrafi 57, 58 që janë me interes
11 të veçantë dhe thotë sa më poshtë:

12 "Çfarëdo lloj procedure ndjek një Gjykatë e Brendshme,
13 Gjykata kërkon që të jetë e tërë, të jetë gjithëpërfshirëse
14 dhe konkluzive në lidhje me çështjen e shtysës për një vepër
15 penale".

16 "Lidhur me parimin e procedurave me palë kundërshtare dhe
17 barazisë së armëve çështja, kjo çështja, pra, ka konstatuar
18 disa garanci të cilat janë të padiskutueshme në kontekstin e
19 mosnxjerrjes së informacionit nga autoritet hetimore".

20 E kuptoni ju këtë?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Kjo lidhet me parashtrimet që
22 i bëra Gjykatësit Gaynor, me palët adversiale, me palë
23 kundërshtare, nuk është absolute. Dhe ajo mund të vendoset
24 midis të tjerave dhe nga skema ligjore e Gjykatës sonë këtu.

25 Në këtë mënyrë Mbrojtja ka pasur mundësinë për të bërë

1 parashtrime e do të ketë mundësi tjera dhe mund të jepet
2 informacion për t'i bërë këto parashtrime.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Por pjesë e gjyqit me
4 palë kundërshtare është nxjerrja, që ju dukeni se nuk po e
5 kuptoni, nuk është thjesht që të dëgjohesh, pra, palë
6 kundërshtare do të thotë të kesh edhe informacion që të jep
7 mundësi të bësh parashtrime efikase dhe të paraqitësh çështjen
8 tënde.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Po vetëm me palë kundërshtare
10 nuk mjafton që të justifikosh nxjerrjen. Në qoftë se kjo do të
11 mjaftonte atëherë rregulli 102(3) nuk do të shkruhet siç është
12 shkruar. Do të kishte pragje -- nuk do të kishte pragje që
13 duheshin përmbushur.

14 Nuk mjafton vetëm të thuash që do të luftojmë Prokurorinë
15 dhe kjo mungon dhe pala nuk -- dhe Trupi Gjykses nuk e ka
16 marrë parasysh në vendimin e saj.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'ju jap një shembull
18 tjetër dhe kjo do të jetë pyetja ime e fundit.

19 Në qoftë se doni një përmbledhje, një version të
20 përmbledhur të kësaj është një guidë për nenin 6, "E Drejta
21 për Një Gjykim të Drejtë", është aspekti penal.

22 Paragrafi 2 thotë:

23 "Në zbatimin e testit procedural dhe material të nxitjes
24 për veprë penale Gjykata duhet pikë së pari të bindet vetë se
25 situata në shqyrtim është *prima facie* hyn në kategorinë e

1 çështjeve për shtytje për vepër penale”.

2 Dhe pastaj në paragrafin 251 [sipas përkthimit] thotë:

3 “Megjithatë, në qoftë se konstatimi i Gjykatës sipas
4 çështjes nuk është përfundimtar për shkak të mungesës së
5 informacionit në dosje mungesa e nxjerrjes apo kontradiktat në
6 interpretimin e palëve të ngjarjeve apo, nëse Gjykata
7 konstaton në bazën e testit substantiv, pra, material se një
8 kërkesë është subjekt i shtytjes, do të jetë e nevojshme që
9 Gjykata të procedojë si një hap tjetër me një rast
10 procedural”.

11 Nuk pajtoheni me këtë?

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Po ju nuk e keni bërë këtë
13 vlerësim që sapo e thatë. Po të kishit pasur një konstatim në
14 atë vendim, atëherë do të justifikohesh do të kishte duhet të
15 kishit bërë një marrë një vendim tjetër. Ajo që keni marrë në
16 vendimin tuaj të kundërshtuar është e parakohshme për t’u
17 marrë në shqyrtim në këtë kohë. Ju e keni marrë vendimin unë
18 nuk do t’ju bind juve për të kundërtën.

19 Po vetëm do të thosha se kjo është një çështje e
20 rëndësishme. Deri në çfarë mase duhen diskutuar këto çështje
21 në një vendim të Gjykatës së Apelit.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ne do të vendosim nëse
23 është plotësisht e pamundur për Mbrojtjen, në qoftë se juve
24 nuk i plotësoni detyrimet tuaja të nxjerrjes. Pra, ju po na
25 kërkonit ne të mos urdhërojmë nxjerrjen duke e vendosur

1 Mbrojtjen në këtë lloj pozite.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, nuk pajtohem plotësisht.

3 Trupi Gjykses e ka të gjithë informacionin e nevojshëm të
4 vendosi nëse do të jetë plotësisht e pamundur që ka ndodhur
5 shtytja për vepër penale.

6 Mbrojtja nuk e ka marrë këtë vendim. Është informacion që
7 nuk e kanë aktualisht. Por Trupi Gjykses e ka pasur të gjithë
8 informacionin që ne kemi pasur si ZPS për të marrë vendimin e
9 vet.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthimi] Faleminderit, z.
11 President.

12 Dy pyetje të shkurtra.

13 Z. Halling, a mund të na shpjegoni dhe njëherë dhe mbase
14 për herë të fundit sot, se si çështjet e ngritura nga ju në
15 kërkesën për certifikim ndikojnë në procesin e shpejtë dhe të
16 drejtë të këtij gjyqi në krahasim me procedurat të hetimeve të
17 tjera aktuale apo të ardhshme veçanërisht duke pas parasysh
18 rrethanat në të cilat ju paraqisni argumentet tuaja?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

20 Përgjigja për pyetjen tuaj është në paragrafin 21 dhe 23
21 të kërkesës sonë. Ne flasim për efektet aktuale dhe të
22 ardhshme. Në këtë çështje diskutohet se nxjerrja e menjëherë
23 që ju urdhëroni komprometon hetimet e ZPS-së. Fakti që krijon,
24 që hap një rrugë për nxjerrje do të thotë se diskutimet -- do
25 të shkaktojnë diskutime të tjera të ardhshme që lidhen me

1 nxjerrjen e materialeve. Këto ndikojnë shumë në procedimin e
2 shpejtë dhe të drejtë të këtyre të këtij procesi.

3 Për vlerësimin tonë, fakti që nuk është me rëndësi
4 materiale në përgatitjen e Mbrojtjes, për vlerësimin tonë, nuk
5 ka të bëjë me rezultatin e gjyqit.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja ime e dytë, ku në
7 jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykatës Evropiane të të Drejtave
8 të Njeriut, të përmendur nga Paneli i Apelit në vendimin e vet
9 të 21 korrikut [sipas përkthimit], në poshtëshënimin 115, ku
10 mund të gjejë Trupi Gjykses mbështetje për parashtrimin tuaj
11 që nxjerrja në çështje që kanë të bëjnë me shtytje për vepër
12 penale nënkupton që pretendimet për shtytje për vepra penale
13 nuk janë plotësisht të mundshme apo se - dhe këtu e kam fjalën
14 te kërkesa juaj në paragrafi 14.1 - "të akuzuarve do t'u
15 kërkohet të bëjnë disa *prima facie* kur të tregojnë se si
16 shtyrja për vepër penale do të kishte ndodhur përpara se të
17 ishte urdhëruar nxjerrja".

18 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të
19 qartë se "në mungesë të provave të tilla është detyra e
20 autoriteteve gjyqësore" të shqyrtojnë "faktet e çështjes dhe
21 të marrin hapat e nevojshme për të zbuluar të vërtetën për të
22 vendosur ka pasur apo jo ndonjë shtytje për vepër penale".

23 Çështja kundër Lituanisë e 5 shkurtit.

24 Pyetja që kam është kjo: Pajtoheni ju se kjo e fundit
25 është pikërisht ajo që ne si Grup Gjykses po përpiqemi të

1 bëjmë këtu?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Ramanauskas nuk ka të bëjë me
3 nxjerrje, me çështjen e nxjerrjes së dokumenteve. Ato janë
4 kryesisht vendime të formës së prerë edhe nxjerrja ka të bëjë
5 me përfundimin e çështjes sigurisht.

6 Por fakti që Trupi Gjykues citon, në atë rast, është një
7 vendim për nxjerrjen e materialeve në kuptimin që TPNJ-ja dhe
8 Gjykata Ndërkombëtare Penale dhe tribunale të tjerë që
9 zbatojnë të njëjtat formulime që janë me rëndësi "materiale
10 për përgatitjen e Mbrojtjes" janë -- e interpretojnë atë në të
11 njëjtën mënyrë sikurse dhe e justifikojnë parashtrimet për
12 këtë pikë.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
15 pushimin. Të vini përsëri në orën 12 pa 20. Deri në atë kohë
16 bëjmë pushim.

17 --- Pauza fillon në orën 11.11

18 --- Seanca rifillon në orën 11.40

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Kalojmë
20 tani në temën tjetër.

21 Trupi Gjykues i kërkoj Mbrojtjes të japi disa vlerësime
22 lidhur me: Kur mund të bëjnë, të paraqesin mocionet e tyre për
23 hedhjen poshtë të një apo të disa akuzave; kur duhet të bëhet
24 konferenca për përgatitjen e Mbrojtjes; Mbrojtja është ftuar
25 për të ofruar detaje sipas rastit lidhur me nëse priten

1 ndryshime materiale për listat e propozuar të dëshmitarëve;
2 dhe nëse Mbrojtja vazhdon ende të thërrasë dëshmitarët -- të
3 akuzuarit si dëshmitarë.

4 Përpara sesa t'i jap fjalën Mbrojtjes, sipas rregullit
5 129, ZPS-ja e ka mbyllur çështjen.

6 ZPS-ja [sipas përkthimit] vuri në dukje se në 5 nëntor,
7 ajo dha një urdhër me gojë për pranueshmërinë e provave
8 materiale përmes Dëshmitarit 4841. Trupi Gjykues duhet të
9 lëshojë arsye të shkruara për këtë.

10 Ajo që pritet të bëhet është edhe pranueshmëria e
11 versioneve më pak të redaktuara të nxjerra nga ZPS-ja në 5
12 nëntor. Ne do të dëgjojmë sot parashtrime për këtë.

13 Pasi ne të lëshojmë arsyet me shkrim dhe rregullat për
14 klasifikimin dhe pranueshmërinë e Paketës 2, të gjitha
15 çështjet që përbëjnë provë dhe janë pjesë e çështjes së ZPS-së
16 do të përfundojnë. Trupi Gjykues synon që të nxjerri vendimin
17 e konsoliduar nesër.

18 Çështjet që kanë të bëjnë me rregullin 102(3), kanë të
19 bëjnë me përgatitjen e Mbrojtjes dhe jo me çështjen e
20 Prokurorisë.

21 Z. Rees, keni fjalën.

22 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

23 Dua të them diçka, disa konstatime shkurt. Në bazë të
24 rregullit të përcaktuar nga ju për udhën që do të vazhdojmë.
25 Jemi të vetëdijshëm për çështjet që vazhdojnë të diskutohen

1 lidhur me nxjerrjen dhe pyetjet e mëtejshme të tre
2 dëshmitarëve të ZPS-së, të cilët janë rezervuar në varësi të
3 nxjerrjes së më tejshme të materialeve. Dhe duke e konstatuar
4 se, si pjesë e vendimit të Trupit Gjykues, F00413, për
5 kundërshtimet e Prokurorisë ndaj nxjerrjes së dokumenteve në
6 njoftimin e përditësuar të rregullit 102(3), në paragrafi 53,
7 Trupi Gjykues vendosi që Mbrojtja duhet lejuar të marrë, si
8 pjesë e procesit të nxjerrjeve materiale të nxjerrshme dhe të
9 rëndësishme për të mundur të përgatitet dhe për të kryer
10 hetime efikase lidhur me to.

11 Për aq sa ZPS-ja, në kohën e duhur, do të kërkojë të
12 sugjerojë se e kanë përmbushur barrën e provës që kërkohet të
13 përmbushin, në themi që provat e ZPS-së ose çështja e ZPS-së
14 përpara mbylljes duhet të përfshijë jo vetëm mundësinë për
15 pyetje të plotë të këtyre tre dëshmitarëve të Mbrojtjes por
16 edhe që ZPS-ja duhet të thërresë edhe qoftë edhe për të
17 paraqitur si dëshmitar të çështjes së tyre, një person që
18 është i aftë të dëshmojë për hetimet që ata kanë kryer lidhur
19 me akuzat për shtytje për veprë penale.

20 Në këto rrethana, ne e kemi të vështirë të bëjmë
21 propozime të qarta lidhur me datat konkrete për çështjet e
22 parashikuar në paragrafin 4(b) dhe (c). Por dëshirojmë që të
23 jemi bashkëpunues, të ndihmojmë dhe unë do të përpiqem të them
24 sesi ne i parashikojmë hapat e tjera edhe pse mund t'ju bjerë
25 ju për detyrë të merrni vendim se ku do t'i fusni këto hapa të

1 mëtejshme në programin e punës.

2 Ne synojmë që të bëjmë një mocion për të hequr dorë në
3 lidhje me pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5. Neve jemi të vetëdijshëm se
4 Rregullorja parashikon për dorëzimin e çdo mocioni për të
5 hequr dorë 10 ditë përpara mbylljes së çështjes së
6 Prokurorisë. Neve jemi të qëndrimit se -- ne vazhdojmë të kemi
7 qëndrimin se është me rëndësi për të gjitha palët, jo më pak
8 për të akuzuarit, që çështjet që kanë të bëjnë me provat të
9 përfundojnë në 17 dhjetor, prandaj jemi të gatshëm të marrim
10 parasysh një periudhë të shkurtuar, në qoftë se është e
11 nevojshme që të lejohet të ndodhë. Megjithatë, kërkojmë një
12 farë kohe të përgatitemi për atë që do të jetë një mocion i
13 hollësishëm për heqje dorë. Një periudhë e shkurtuar p.sh.,
14 deri të premten 17, mbase mund të ndihmojë.

15 Jam i vetëdijshëm kur e sugjeroj këtë se më parë e kemi
16 shqyrtuar nëse datat 15 dhe 16, janë dy ditë kur ZPS-ja do të
17 mund të bëjë të disponueshëm ndonjë dëshmitar tjetër për të
18 cilin pyetjet tona do të përfundojnë. Dhe ne do të thoshim se
19 këta dëshmitarë të aftë për të dëshmuar për hetimet e procesit
20 me anë të të cilave materialet janë dorëzuar në OVL UÇK do të
21 jenë të diponueshëm për të përfunduar, për të plotësuar
22 çështjen e ZPS-së.

23 Aktualisht nuk jemi të sigurt nëse ndonjë pyetje tjetër
24 nga ana jonë do të bëhet duke pasur parasysh urdhrin e
25 ndryshuar gjatë javës që shkoi. Sepse aktualisht ka një

1 kërkesë, pra, për nxjerrje që gjithashtu dhe hetime të
2 mëtejshme për ushtrimin e nxjerrjes deri në 12 nëntor.

3 Ne jemi të vetëdijshëm se Rregullorja parashikon ofrimin
4 e një liste dëshmitarësh dhe provash materiale të propozuara
5 dhe një konferencë mbas shtatë ditësh të Mbrojtjes, për
6 përgatitjen e Mbrojtjes për të ndihmuar Gjykatën. Synimi ynë
7 është që t'i rikthehem listës sonë të propozuar të
8 dëshmitarëve me idenë për të siguruar që të jetë sa më e
9 shkurtër që të jetë e mundur. Por e kemi të vështirë në këtë
10 fazë të japim ndonjë indikacion tjetër lidhur me mocionet për
11 të hedhur poshtë, lidhur me fushëveprimin e akuzave dhe në
12 fakt, nxjerrjet e mbetura.

13 Nga ana e z. Gucati, qëllimi është, në këtë fazë të
14 paktën, që z. Gucati do të thirret për të dhënë dëshmi. Por
15 nuk them gjë. Unë mendoj se është e papërshtatshme që t'i
16 kërkohet një vendim përfundimtar për këtë gjë nga ana e z.
17 Gucati, pa qenë plotësisht i bindur për objektin e çështjes së
18 tij, me qëllim që ai vendimin ta marrë duke pasur këshillat e
19 duhura, duke i ditur plotësisht të gjitha çështjet që lidhen
20 me një vendim të tillë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ne nuk
22 kërkojmë ndonjë angazhim, thjesht kërkojmë një indikacion.

23 Z. REES: [Përkthim] Po shpresoj që e dhashë një
24 indikacion të tillë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po e

1 dhatë.

2 Z. REES: [Përkthim] Po, më e mira që mund të bëj unë.
3 Lidhur me afatin apo programin e punës, neve dëshirojmë të
4 jemi në gjendje që ta fillojmë çështjen tonë si Mbrojtje në
5 datën 2 dhjetor, që është data e parë e seancave të Gjykatës
6 duke pasur vetëm datën 15 dhe 16 midis asaj date dhe tani.

7 Ne duam të bëjmë një deklaratë hapëse por do ta trajtojmë
8 me kujdes për të qenë të bindur që në këto rrethana të jemi sa
9 më shkurtër dhe të flasim në mënyrën sa më të duhur.

10 Tani si të shkojmë -- që tani deri në 2 dhjetor, ne e
11 kemi të vështirë që ta themi, sepse na duket sikur ka shumë
12 çështje të pasigurta me të cilat ne nuk ju ndihmojmë dot si
13 Trup Gjykues.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E keni
15 fjalën për thirrjen e dëshmitarëve në 2 dhjetor? Apo -- nuk e
16 kemi diskutuar konferencën e Mbrojtjes që duhet të ndodhi
17 përpara asaj kohe, sigurisht.

18 Z. REES: [Përkthim] Po, po, patjetër. Për t'ju ndihmuar,
19 ne përpiqemi të japim sa më shumë ndihmë sot për gjithë
20 fushëveprimin e përgjithshëm të çështjes së Mbrojtjes. Pra,
21 kjo lidhet me çështjen e diskutimeve, e nxjerrjes së
22 materialeve, mocionet për të hedhur poshtë akuzat 5, 6, të
23 cilat mund ta ndryshojnë objektin e çështjes sonë. Pra, do të
24 ecim me kujdes që ju si Trup Gjykues të planifikoni si duhet
25 punën.

1 Pra, na duket, se konferenca zyrtare e përgatitjes tonë
2 mund të bëhet me një njoftim të shkurtër dhe mund të jetë
3 relativisht e shkurtër vetë. Po jam i vetëdijshëm, se ngaqë ka
4 shumë çështje, siç thashë të pasigurta dhe mund të dalin
5 çështje që Prokuroria mund të dojë t'i ngrejë dhe ato mund të
6 kenë një mendim tjetër lidhur me konferencën tonë përgatitore
7 që t'i mbarojmë procedurat e provave deri në 17 dhjetor, do të
8 ishte mirë që të kishim një konferencë të shkurtër përgatitore
9 pastaj të futeshim menjëherë në deklaratën hapëse dhe pastaj
10 të fillonim thirrjen e provave.

11 Besoj që mund t'ju ndihmoj.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, na
13 ndihmon. Dhe e vlerësoj faktin që juve po kërkonti t'i
14 shkurtoni afatet dhe ne do të bëjmë maksimumin tonë. Duhet të
15 marrim disa vendime sot e ndoshta dhe nesër dhe do t'ju
16 këshillojmë.

17 Z. REES: [Përkthim] Dakord që ne duam t'i shkurtojmë, po
18 jo t'i shkurtojmë fare.

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Sigurisht nuk do të parashtroj
20 ndonjë qëndrim të ndryshëm nga z. Rees. Sepse e kemi
21 diskutuar, kam marrë dhe udhëzime nga z. Haradinaj, i cili dhe
22 ai mezi pret që çështja të eci përpara sa më shpejt që të jetë
23 e mundur por siç tha z. Rees ka disa çështje të cilat duhen
24 diskutuar lidhur me caktimin e një afati të caktuar.

25 Mbasi i kemi diskutuar me z. Rees, z. Haradinaj, duam

1 t'ju ndihmojmë sa më shumë që të jetë e mundur. Pajtohem me
2 kalendarin, si të thuash, të propozuar nga z. Rees edhe për
3 hedhjen poshtë të disa akuzave të cilat do t'i bëjmë.

4 Aktualisht po shikojmë nëse duhet të bëjmë një kërkesë
5 për një zgjatje të materialit sepse janë shumë fjalë, kufiri i
6 fjalëve është 6.000. Por nuk e di nëse do të na mjaftojnë.
7 Synimi ynë në këtë fazë është që edhe z. Haradinaj të thirret
8 për të dhënë dëshmi. Por shumë nga kjo varet dhe nga çdo të
9 ndodhi këtu.

10 Lista aktuale e dëshmitarëve, sipas vendimit tuaj, do të
11 varet nga rezultati i disa çështjeve por neve do bëjmë çmos
12 t'ju ndihmojmë sa më shumë që të jetë e mundur.

13 Kemi një listë të përbashkët dhe nuk do të përsërisim
14 dëshmitarët. Pra, ose njëri ose tjetri do të thërrasë
15 dëshmitarë që mund t'i shërbejnë interesave të të dyve, për të
16 ndihmuar Gjykatën në këtë mënyrë. Por, megjithatë, ka disa
17 çështje që duhen zgjidhur, kështu që, është e pamundur që të
18 japim, të themi më shumë se kaq.

19 Siç tha z. Rees, ka çështje të cilat duhen vendosur
20 përpara sesa çështja e Prokurorisë të mbyllet zyrtarisht. Në
21 këtë fazë kaq mund të them.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] E
23 vlerësojmë ndihmën tuaj, do të hartojmë një urdhër që t'i
24 përcaktojmë të gjitha këto çështje.

25 Tani do të adresojmë kërkesën e Prokurorisë për pranim.

1 Në 5 nëntor 2021, Trupi Gjykes e ftojë ZPS-në të nxirrte
2 një version të redaktuar të P104 MFI, që njihet si Paketa 2
3 dhe të arrijë dërguar materialin për pranim.

4 ZPS-ja nxori një material të redaktuar prej pesë faqesh
5 shoqëruar me përkthimin në anglisht. Duke pasur parasysh se
6 këto faqe kanë dalë në Paketën 4, ZPS-ja ka nxjerrë faqet
7 korresponduese me këto paketa dhe me redaktimet përkatëse.

8 ZPS-ja kërkoi që faqet e nxjerra të mbeteshin
9 konfidenciale.

10 Besoj që e shpreha si duhet qëndrimin tuaj?

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mbrojtja
13 e kundërshton këtë kërkesë, z. Rees?

14 Z. REES: [Përkthim] Po e kundërshtojmë. Nuk ka mocion të
15 bërë këtu në gjyq dhe neve kundërshtojmë në këtë bazë.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Edhe ne ashtu mendojmë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] ZPS-ja
18 dëshiron të përgjigjet?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, për ta sqaruar, kërkesa
20 është e barabartë me një kërkesë për pranim nga tavolina këtu
21 me idenë që ato gjashtë faqet shtesë që janë nxjerrë sipas një
22 urdhri të Trupit Gjykes autenticiteti i tyre është vërtetuar
23 përmes dëshmisë së Dëshmitarit 4841, që theksoi të gjitha
24 çështjet e lidhura me autenticitetin e Paketave 1 dhe 4 që
25 përmbajnë gjashtë faqet korresponduese të Paketës 2.

1 Si të tilla të dy çështjet e autenticitetit dhe
2 relevancës janë vërtetuar përmes dëshmitarit 4841 dhe
3 relevanca, pra, lidhur me materialet konfidenciale që ZPS-ja i
4 ka nxjerrë pa autorizimin -- që pretendoi se i ka nxjerrë pa
5 autorizimin e të akuzuarve.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Na duhet
8 që caktojmë, t'u ngjisim numrat të rinj kërkesës shtesë. Kemi
9 vetëm P104 MFI deri tani.

10 [Anëtarët e Trupit Gjykues dhe Sekretarja e
11 Gjykatës këshillohen]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do ta
13 marrim në shqyrtim kërkesën për pranim në prova dhe do ta
14 përfshijmë në vendimin përmbledhës nesër.

15 Z. REES: [Përkthim] Në rregull. A mund të ngre dhe një
16 çështje tjetër shtesë?

17 Jemi përpjekur që të ndihmojmë në kalendarin e procesit
18 ndër të tjera dhe duke bërë të qartë që aktualisht do të
19 paraqesim një mocion për pranueshmërinë - më falni- një mocion
20 për rrëzim të pikave nga një deri në pesë. Edhe pse kemi akoma
21 probleme të pazgjidhura të nxjerrjes. A mund të themi se kjo
22 nuk duhet që të cenohet të drejtën për të parashtruar ndonjë
23 mocion që mund të lindë kur të përfundojë nxjerrja. Për
24 shembull, një mocion për të përjashtuar prova dhe prova sipas
25 rregullit 102(3) [sipas përkthimit] kur këto prova janë marrë

1 në shkelje të ligjit apo në shkelje të të drejtave të njeriut
2 sipas konventave ndërkombëtare apo ndonjë mocion në lidhje me
3 mosnxjerrjen që çojnë në një gjykim të padrejtë.

4 E thënë shkurt, pra, nuk e kemi problem të vijojmë edhe
5 pse ka probleme të nxjerrjes që nuk kanë marrë zgjidhje ende,
6 me kusht, që kjo mos të na pengojë në të ardhmen kur të kemi
7 nxjerrjen e plotë të bëjmë ndonjë mocion, p.sh., që edhe pika
8 6 e Aktakuzës duhet rrëzuar gjithashtu në bazë të faktit që
9 provat në lidhje me këto çështje duhen të deklarohen të
10 papranueshme në bazë të pretendimeve për shtytjen në krim.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Nuk
12 cenoheni, pra, nuk do të pengoheni që të bëni mocion në asnjë
13 moment nga ndryshimi i kalendarit. Ju lirisht mund t'i
14 parashtroni këto mocione kur të vijë momenti dhe nëse
15 dëshironi t'i bëni.

16 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ndonjë gjë
18 tjetër nga dikush përpara se të vijojmë me deklaratat e të
19 akuzuarve?

20 Po, z. Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Për t'ju bërë një përditësim lidhur
22 me akt-ekspertizën shtesë.

23 Ne jemi mirënjohës për vënien në dispozicion të
24 transkripteve. Në mënyrë që eksperti t'i shqyrtojë -- ka
25 shqyrtuar gjatë fundjavës. Dhe ai po bën çmos që të dorëzojë

1 akt-ekspertizën nesër. Do të verifikojë dhe me të sot dhe do
2 ta përditësojë Trupin Gjykses nëse do të jemi në gjendje që të
3 përmbushim afatin në mbyllje të ditës nesër. Por, ne mendojmë
4 se do të protokollohet nesër përpara fundit të ditës nesër.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po, mund
6 të veproni kështu. Faleminderit.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nëse mund të ndërhyj një çast.
8 Në lidhje me sugjerimin e Mbrojtjes së Gucatit që Prokuroria
9 të sjellë dëshmitarë të tjerë shtesë si pasojë e nxjerrjes në
10 bazë të rregullit 102(3), mund të konfirmoj që Prokuroria nuk
11 ka ndërmend që të sjellë dëshmitarë të tjerë pavarësisht nga
12 rezultati i zgjidhjes së çështjeve mbeten ende për të marrë
13 zgjidhje, për sa i takon rregullit 102(3).

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
15 Faleminderit. Besoj se e kuptoni që Mbrojtja mund të
16 rithërrasë disa prej dëshmitarëve tuaj për t'i bërë pyetje të
17 tjera?

18 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Këtë e kuptoj. Po ishte
19 sugjerimi që ne mund të thërrasim dëshmitarë të tjerë veç
20 tyre. Por jo, nuk kemi ndërmend.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]
22 Faleminderit për sqarimin.

23 Z. Rees, klienti juaj a është gati që të vijojë me
24 deklaratën?

25 Z. REES: [Përkthim] Po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Dhe z.
2 Cadman, klienti juaj është gati që të mbajë deklaratën?

3 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Do të
5 vijojmë me deklaratat jo të bëra nën betim.

6 Secilit prej të akuzuarve i jepet 15 minuta kohë për të
7 folur. Deklaratat duhet që të fokusohen dhe të mos dalin
8 jashtë çështjeve që janë me rëndësi për këtë procedurë. Kështu
9 që, u lutem, të akuzuarve të mos bëjnë deklarata me natyrë
10 politike dhe të fokusohen tek aspekte që kanë rëndësi për këtë
11 çështje gjyqësore.

12 U lutem të akuzuarve, që të flasin sa më ngadalë në
13 mënyrë që përkthyesit të na e përkthejnë deklaratën tuaj.

14 Z. Gucati do të filloj me ju. Keni fjalën.

15 I AKUZUARI GUCATI: Të nderuar të pranishëm në sallë, të
16 nderuar Gjyqtarë, e nderuar e pranishme e Ambasadës së Kosovës
17 Yllka Geci, dëshiroj që në mënyrë të shkurtë të ndaj me ju
18 historinë e vendit tim.

19 Jam lindur dhe rritur në një vend liridashës të Kosovës,
20 në Drenicë. Unë vijoj nga një fshat, Morinë i Komunës së
21 Skënderajt, fshat i imi është fshat që në luftën e fundit ka
22 humbur më së shumti njerëz për kokë banori. Ku gjithsej 13 për
23 qind e qytetarëve të fshatit tim të vrarë. Në vitet 1997,
24 1998, së bashku me babain tim, jemi bashkuar radhëve të
25 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'i mbrojtur të drejtat më

1 elementare të njeriut bashkohor, siç janë liria dhe e drejta
2 për jetë të lirë e të dinjitetshme në vatrat tona.

3 Në luftimet e qershorit të vitit '99, në kohën e
4 bombardimeve të NATO-s unë jam plagosur nga forcat serbe
5 paraushtarake dhe policore të Serbisë. Si pasojë e asaj
6 plagosje sot jam invalid dhe nuk mund të eci si të gjithë
7 njerëzit e tjerë.

8 Ne si popull më i vjetër në Ballkan dhe i Evropës nuk e
9 kemi pushtuar Serbinë, përkundrazi populli dhe vendi ynë ka
10 qenë i pushtuar nga Serbia qysh se në prag të Luftës së Parë
11 Botërore.

12 Këtu ku jemi me të padrejtë që më shumë se një vit jemi
13 krejt të pafajshëm. Ne nuk e kemi bërë asnjë mëkat veçse e
14 kemi shfrytëzuar --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Gucati,
16 ju kërkova që të mos hyni në këto hollësi të cilat ne nuk po
17 shqyrtojmë në këtë proces gjyqësor. Unë e kuptoj kontekstin
18 por do ju lutesha që ta shmangni, domethënë ato lloj
19 argumentesh që janë me natyrë politike, siç do t'i thosha unë.
20 Ju lutem, që të përqendrohemi tek ky proces gjyqësor.

21 Z. REES: [Përkthim] Ne parashtrojmë se interesi publik
22 është pjesë e këtij procesi gjyqësor si një aspekt me rëndësi.
23 Z. Gucatit nuk është se i ka mbetur shumë nga deklarata. Ju
24 lutem të duroni, ka shumë më pak sesa 15 minuta nga ç'keni
25 caktuar, mund ta dëgjoni deri në fund.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po. Mund
2 të vijoni.

3 Z. Gucati mund të vazhdoni. Po ju lutem mbani parasysh
4 ato që sapo thashë.

5 I AKUZUARI GUCATI: Faleminderit. Veç se kemi shfrytëzuar
6 të drejtën tonë të fjalës së lirë, të mendimit të lirë dhe të
7 shprehjes së lirë. Të drejtat që kemi fituar me sakrifica të
8 shumta njerëzore dhe jo vetëm njerëzore. Vetëm gjatë marsit,
9 prillit, majit e qershorit të vitit 1999 mbi popullin tonë
10 janë kryer mbi 450 masakra dhe krime të gjenocidit serb.

11 Pa i përmendur ato të viteve 1990. Gjatë luftës së fundit
12 në Kosovë janë vrarë mbi 1.400 fëmijë, janë dhunuar mbi 20.000
13 femra, janë vrarë mijëra pleq të mbetur e të palëvizshëm që
14 nuk kanë mundur të largohen nga shtëpitë e tyre. As sot e
15 kësaj dite nuk dimë për fatin e mbi 1.600 njerëzve. Pa folur
16 për shkatërrime të shumta që makineria ushtarake policore
17 serbe ja shkaktuar vendit e kombit tim.

18 Prandaj, është e drejtë e imja legjitime që t'i mbroj të
19 drejtat dhe vlerat e kombit tim, të Ushtrisë Çlirimtare të
20 Kosovës dhe të Republikës së shtetit tim të Kosovës. Dhe këto
21 vlera janë gjithnjë njerëzore.

22 Unë jam i obliguar që t'i mbroj të drejtat e liritë e
23 popullit tim, për një jetë më të mirë e më të begatë, si të
24 gjithë popujt e kontinentit tonë.

25 Faleminderit që patët mundësi që të më jepnit fjalën.

1 Faleminderit që më dëgjuat.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Gucati.

4 Z. Haradinaj, keni fjalën.

5 I AKUZUARI HARADINAJ: Ju faleminderit.

6 Të nderuar anëtarë të Panelit të Gjykatës dhe ju
7 përfaqësues të shtetit tim që jeni sot aty dhe më dëgjoni.
8 Këto komente të shkurtra i bëj si qytetar krenar i Republikës
9 së Kosovës, që i është nënshtruar një procesi nga Prokuroria
10 që mund të cilësohet vetëm si i padrejtë dhe selektiv. Tani ju
11 bëj thirrje, të nderuar Gjyqtarë, që një institucioni kombëtar
12 të vendit tim të lindjes, ta përfundoni këtë çështje.

13 Jam trajtuar me përbuzje të plotë nga Prokuroria dhe
14 javët e fundit, madje muajt e fundit, kanë treguar fare qartë
15 për të gjithë se frika jonë më e madhe është realizuar. Edhe
16 pse Prokuroria nuk e meriton aspak që unë të jem këtu i
17 pranishëm në këtë sallë dhe tua bëj dekorin figurativ,
18 gjithsesi, në shtyri parimi bazë, që për të vërtetën nuk duhet
19 hezituari kurrë. Dhe përballja me ata që kërkojnë të shpifin
20 dhe poshtërojnë gjithçka që ne mbrojmë duhet bërë pikërisht
21 për hir të kësaj të vërtete.

22 Pra, vendosa të vij këtu dhe të them të vërtetën për hir
23 të opinionit të përgjithshëm. Veprimet dhe sjellja e kësaj
24 Prokurorie jo vetëm do gjesh, që dëshmon për sjellje jo të
25 mirë të kësaj Prokurorie, po dëshmon se unë jam këtu prej 14

1 muajsh ku nuk ka asnjë provë që të mbështesë akuzat qesharake
2 me të cilat përballem.

3 Mënyra sesi Prokuroria kërkon të bëjë këtë me dyer të
4 mbyllura është gjithashtu thellësisht e turpshme. Unë them se
5 një Prokurori po e vërteton -- se kjo Prokurori po e vërteton
6 katërfish atë që thoshim unë dhe OVL UÇK-ja për ta.

7 Unë kam qëndruar gjithmonë për drejtësinë dhe do të
8 qëndroj gjithmonë për drejtësi. Unë nuk mbroj asnjë njeri që
9 ka kryer një krim. Kushdo që ka kryer një krim gjatë çlirimit
10 të pavarësisë sonë nga regjimi i shtypjes së Millosheviçit,
11 nuk meriton aspak dhe nuk duhet -- dhe duhet të përballlet me
12 drejtësinë.

13 Po, gjithashtu, duhet të sigurohemi që procesi të jetë i
14 drejtë, të është transparent që të mos korruptohet nga
15 politika dhe mbi të gjitha të adresojë krimet e kryera nga ata
16 që bëjnë përgjithësinë, që mbajnë përgjegjësinë më të madhe.

17 Janë të njëjtët persona, emrat e të cilëve dëgjuam në
18 këtë sallë gjyqi, të cilët kanë gjak në duar e tyre dhe që
19 Prokuroria tani kërkon t'i mbroj nga publiku për të shpëtuar
20 turpin e saj.

21 Prokurori Jack Smith, qëndroi para jush, të nderuar
22 Gjyqtarë dhe tha se kjo nuk ka të bëjë me UÇK-në. Nuk bëhet
23 fjalë për shqiptarët e Kosovës. Kjo është një gënjeshtër.
24 Pikërisht për këtë bëhet fjalë. Dëshmitarët e paraqitur
25 treguan se asnjë rast nuk është ngritur kundra agresorëve

1 serbë që shkaktuan vdekjen e 11.000 shqiptarëve të Kosovës.

2 Ne i kemi theksuar dyshime të tilla qysh nga themelimi,
3 bazuar në një thënie të popullit tim i cili e ka vuajtur shumë
4 dhe thotë "Një punë që nis mbrapsht apo keq, ajo nuk mund të
5 përfundojë ndryshe vetëm se mbrapsht dhe keq".

6 Pra, nga iniciativa për formimin e kësaj Dhome, mbi bazën
7 e shpifjeve të shtetit serb për gjoja trafikim organesh dhe
8 deri te Dick Marty, i cili u promovua nga qeveria e Beogradit,
9 një qeveri e përbërë nga autorë të krimeve të Millosheviçit ku
10 vetë opinionin ndërkombëtar, por edhe vendet nga ju vini si
11 prokurorë dhe gjyqtarë, e vlerësuar dhe e emërtuar me emrin
12 tash të njohur në mbarë botën si kasapi i Ballkanit.

13 Dhe shikoni tani. Po këta bashkëpunëtorë të Millosheviçit
14 të njëjtët me një transformim taktik, si kameleoni, po i
15 drejtojnë këto raste. Ndërsa me trupin e tyre nuk mund të
16 fshehin kurrë urrejtjen ndaj asnjë kombi tjetër që nuk është
17 serb ose nuk pranon nënshtrimin dhe vasalitetin ndaj tyre.

18 Ky mentalitet është vërtetuar brez pas brezi. Të paktën
19 nuk të mund ta mohoni faktin që jeni dëshmitarë të ngjarjeve
20 ku brenda 10 vitesh ata filluan dhe kryen 5 luftëra shfarosëse
21 e gjenocidi dhe ndaj atyre me të cilët bashkëqeverisnin dikur
22 Jugosllavinë.

23 Pra, pikërisht këta sot janë akomoduar në qeverinë e
24 Serbisë, pra, të njëjtit që provokuan, ekzekutuan dhe u
25 udhëhoqën këto luftëra. E ndërsa kjo Prokurori po i vlerëson

1 dhe i falënderon për shqyrtimin e kujdesshëm dhe kontributin e
2 tyre që po japin në këtë Prokurori.

3 Dua të theksoj këtu para jush, se gjatë kohës që kam qenë
4 këtu, kam pasur kohë dhe kam bërë një krahasim me ish-
5 prokurorët dhe burgjet komuniste të Jugosllavisë të viteve
6 1981. Ku këtë e kemi mbijetuar plotësisht si familje. Duke
7 filluar nga babai im, vëllai im i madh, personalisht para se
8 ti mbushja 18 vjeç, me motrën time 15-vjeçare, vëllain tjetër
9 14-vjeçar, motrën time të vogël e cila ishte vetëm një fëmijë
10 në klasën e gjashtë të shkollës fillore, duke mos harruar
11 nënën time dhe më vonë pas martesës, edhe gruan time. Ku ishin
12 të burgosur dhe të persekutuar nga vendi ynë që të gjithë.
13 Duke na ndaluar arsimin, punësimin, ku iu nënshtruam burgjeve
14 dhe torturave të tjera shtetërore.

15 Dhe nëpër dokumente tuaja rezultojnë se keni të dhëna
16 edhe për këta persona të përndjekur që nga viti 1981. Ndaj
17 këtu kuptohet qartë se ku e keni synimin dhe çfarë drejtimi ka
18 marrë kjo Prokurori. Ja krahasimet e mia. Edhe Prokurorët e
19 asaj kohe u avancuan nga regjimi i Beogradit dhe u legjitimuan
20 në parlament. Pra, këto dhoma janë të inkurajuara edhe nga
21 Beogradi dhe të iniciuara nga Dick Marty dhe të miratuar në
22 Parlamentin Evropian.

23 Nën dy. Gjykatat e sistemit serbë të asaj kohe vazhduan
24 të punojnë me oficerët e tyre hetues për të krijuar dëshmitarë
25 me joshje dhe presion ndaj tyre. Kjo Prokurori, po ashtu, po

1 përpiqet të sigurojë dënime të njëanshme pa i hetuar veprat e
2 padrejta --

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.
4 Haradinaj.

5 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Gjykatës, unë mendoj se --
6 urdhno.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z.
8 Haradinaj, ju kemi dhënë shumë tolerancë për kontekstin, por
9 duam të fokusoheni tek kjo çështje gjyqësore dhe jo...

10 I AKUZUARI HARADINAJ: Pikërisht aty zoti Gjykatës jam.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po flisni
12 për historinë. Dua që të flisni për çështjen gjyqësore siç po
13 zhvillohet këtu sot. Nuk është se dua t'ju ndaloj por do t'ju
14 ndaloj nëse do vazhdoni me këto argumente.

15 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Gjykatës unë jam ka foli
16 pikërisht për të tanishmen.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] Besoj se z. Haradinaj ka edhe rreth
19 pesë minuta.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Udhëzimet
21 e mia janë mjaft të qarta. E kemi toleruar shumë për këtë
22 kontekst të gjerë po duam të fokusohemi te çështja gjyqësore.
23 Nuk duam diskutime për luftën apo për veprime të pretenduara
24 që mund të kenë bërë të tjerët. Duam të fokusohemi tek kjo
25 çështje. Ju lutem, udhëzoheni klientin tuaj.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, i është dhënë
2 mundësia që të mbajë një deklaratë jo nën betim. Ai nuk është
3 i detyruar që ta bëjë deklaratën sipas mënyrave që udhëzojnë
4 Gjykatësit.

5 Z. Haradinaj po flet për atë që ai mendon se ka lidhje me
6 atë që i ka ndodhur atij.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Lexoni
8 rregulloren për deklaratën. Duhet që këtë lidhje me çështjen
9 gjyqësore.

10 Z. CADMAN: [Përkthim] Po ka lidhje me çështje gjyqësore,
11 i nderuar Gjykatës. Nëse mund t'i jepni dhe pesë minuta të
12 tjera që ta përfundojë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vetëm
14 udhëzoheni klientin që të mos flasë me hollësi, me ato hollësi
15 për të cilat foli dhe pastaj ja jap dhe pesë minutat.

16 Mund të përdorni një ton normal. Dhe s'është nevoja që
17 flisni me zë kaq të lartë.

18 I AKUZUARI HARADINAJ: Zoti Gjykatës, ju e keqkuptoni po
19 ky është toni im natyral. Më vjen keq, e kam prej lindje.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni z. Haradinaj. Keni pesë minuta.

22 I AKUZUARI HARADINAJ: Faleminderit. Pra, këtu kam një
23 shpresë, që të paktën ky Trup Gjykses, të jetë ndryshe nga
24 ata. Të paktën të keni durim dhe të na dëgjoni me vëmendje.

25 Ju këtu mund të mos besoni këtë që po flas për tundime

1 dhe presionet që oficerët e kësaj Prokurorie i bëjnë gjërat
2 atje në Kosovë. Unë po jua vërtetoj.

3 E njëjta Prokurori, në mungesë të provave, si bazë ka të
4 dhëna nga koordinatori i saj në Beograd, i merr emrat dhe
5 provat e përpunuara që nga kohët e lashta, para dhe pas luftës
6 dhe i ka futur të njëjtat si objektiv të tyre. Këta persona
7 qofshin si ish-të pandehur apo si ish-dëshmitarë të mëparshëm
8 përmenden këtu dhe po duhet ta sqaroj, se këto dëshmi në atë
9 kohë janë nxjerrë në atë kohë lufte. Prokuroria serbe i ka
10 nxjerrë me armë, me thika në fyt.

11 Po e kanë modifikuar sot qofshin provat apo aktakuzat.
12 Vetëm tani kanë ndryshuar pak duke i afruar azil jashtë vendit
13 apo dhe privilegje punësimi apo nëse kanë qenë ata që kanë
14 kryer krime, trafik droge, vrasje seriale e tjerë, ju është
15 afruar amnistia vetëm për t'i vendosur ata si dëshmitarë
16 përkatës të Prokurorisë. Gjë që vërtetohet dhe sot nga listat
17 e kërkuar nga Interpoli, ndërkohë që të tillat ende mbrohen në
18 Prokurori për interesa të saj.

19 Pra, hetuesit e ZPS-së edhe pse tani gjysëm shekulli më
20 vonë dhe duke pasur parasysh performancën e lartë profesionale
21 dhe duke mos mbajtur anën që propagandojnë dhe thirren ato, po
22 them, që oficerët e ZPS-së, personat që i kanë vënë në
23 shënjestër, nuk i ftojnë në mënyrë normale por përkundrazi i
24 nënshtrojnë kushte frike dhe frikësimi.

25 Pra, Prokuroria serbe në emër të Gjykatave të Kosovës na

1 ndoqi dhe na dënoi kur mjaftonte të plotësonim vetëm dy
2 kushte. Në një, duhet të ishim një etnik, pra, duhet të ishim
3 shqiptarë dhe, këtë objektiv e ka dhe ZPS-ja, selektiv, pra,
4 që nuk pajtoheshim me robërinë. Njësoj, pra, si e kanë edhe
5 çlirimtarët. Mundimin, kur nuk mund të siguroheshin prova, ata
6 i kurdisnin gjërat. Të njëjtën gjë po edhe sot kjo Prokurori.

7 Pra, konkludoj se objektivi dhe metodat janë saktësisht
8 të njëjta me faktin se të dhënat që ju i referoheni, me
9 dokumente që kanë dalë nga zyra juaj, keni vërtetuar se të
10 vetmet burime janë ato serbe. Konkretisht aktakuzat e asaj
11 kohe dhe me po të njëjtët emra. Keni një koordinator që
12 organizon, si më poshtë, Milovan Dreçunin, njeriu i njohur
13 zyrtarisht si nga më të besuarit e Millosheviçit. Duke qenë se
14 ky, jo që është vetëm djali i një oficeri të sigurimit sekret
15 ushtarak, po ai vet ka ushtruar këtë profesion si ish-punonjës
16 atje. Derisa u gradua me një detyrë të re speciale me të
17 njëjtin titull që tani e ka si koordinator i shtypit të luftës
18 për Kosovë.

19 Gjithashtu, tregon se keni dashur të bashkëpunoni me
20 [REDAKTUAR], i
21 cili udhëhoqi vrasjet masive të mbi 372 civilëve duke
22 përfshirë gra, të moshuara, fëmijë, disa prej të cilëve dhe
23 janë zhdukur.

24 Po përmend vetëm katër raste ku është vështirë të besohet
25 se kjo mund të jetë rastësi, pra, veprimet konkrete të këtij

1 koordinatori të besueshëm, Milovan Dreçunit, që ju e keni dhe
2 që në të paktën dy raste ka qenë personalisht i pranishëm.
3 Duke shtuar këtu edhe masakra të tjera si ajo e Qirezit,
4 Likoshanit, [e pakuptueshme] e qindra tjera anë e anë Kosovës.

5 Fshatin Lubeniq të Komunës së Pejës, së paku për
6 Prokurorinë ky vend nuk duhet të jetë i panjohur, sepse është
7 vend ku kanë ndodhur vrasje dhe masakra sistematike. Në vitet
8 1980, një djalë i ri dhe me perspektivë intelektuale i quajtur
9 Mal Morina, shërbimi sekret e arrestoi disa herë që në
10 shkollën e mesme, për ta marrë në pyetje, duke i bërë tortura
11 sistematike së bashku me presion psikologjik. Dhe kjo vetëm
12 prej ideve dhe mendimin e shprehjes së lirë. Pasi e arrestuan
13 një pasdite dimri ata dyshohet se e liruan. Ku më vonë u gjet
14 i varur në litar në moshën 23 vjeçare në një pronë serbi, po
15 atë ditë. Asgjë nuk ndodhi më. Askush nuk dha asnjë
16 përgjegjësi. Asnjë shpjegim. Asnjë zyrtar shtetëror vetëm për
17 të pohuar se në mesditën e asaj mbrëmjeje e kishin liruar.

18 Në të njëjtin fshat në Lubeniq, pas shpërthimit të luftës
19 1998, ndodhi masakra e parë e kryer nga forcat policore dhe
20 ushtarake, ku mbetën të vrarë disa banorë të këtij fshati.
21 Megjithatë, asnjë nga këto, askush nuk u interesua pavarësisht
22 provave të dhëna dhe sot që ka prova, po në këtë Prokurori,
23 për autorët e këtyre akte.

24 Përsëri në të njëjtin vit më vonë në fshatin Lubiniq, në
25 fillim të vitit 1999, u bënë masakra me elementet e

1 gjenocidit. Fillimisht plaçkitje, torturime, ekzekutime pa
2 përjashtim të asnjë moshe dhe më pas djegie të gjallë [e
3 pakuptueshme] një qytetarëve civilë mes tyre pleq të moshuar
4 dhe fëmijë.

5 Katër. Përsëri në këtë fshat të Komunës së Pejës,
6 gjerësisht në Lubiniq, ripërsëritet në të njëjtin vit, pra, në
7 vitin 1999 e njëjta metodë si me Mal Morinën. Vetëm që tani
8 ndryshon mënyra e ekzekutimit të personit. E kam fjalën këtu
9 për veprimtarin, profesorin, filozofin dhe mendimtarin dhe
10 atdhetarin që ligjëroi në universitetet më të njohura të
11 botës, pra, ky është Ukshin Hoti. I cili nga burgu famëkeq i
12 Dubravës u soll në këtë fshat dhe u ekzekutua duke i vënë
13 tritolin në kokë. Këtë ngjarje e ka dëshmuar një anëtar i po
14 këtyre forcave nën një televizion serb.

15 Prandaj bazuar në këto fakte dhe shumë të tjera konkludoj
16 dhe jam i sigurt se në ka dëshmitarë okular që kanë dëshmuar
17 para ndërkombëtarëve ku janë identifikuar ekzekutorë dhe
18 autorë të këtyre akteve makabre. Dhe njëri prej tyre që mund
19 të flasë për këto, është koordinatori zyrtar i po kësaj
20 Prokurorie, Milovan Dreçun.

21 Ky vetë në shtypin e asaj kohe ka shkruar për të njëjtën
22 nga këto ngjarje duke arsyetuar vrasjen e civilëve në fshat si
23 reagim normal të forcave serbe pasi para disa ditësh i sulmuan
24 forcat serbe.

25 Prandaj, ky është emëruar nga Millosheviçi për të kryer

1 propagandën e luftës, i cili është marrë edhe me mua në
2 deklaratat e saj.

3 Që të përfundoj, për arsye të kërkesës suaj zoti
4 Gjykatës, sepse i kam edhe një faqe e gjysëm, vetëm po dëshmoj
5 diçka për këtë rast. Vetëm informatë për ju që mund ta
6 vërtetoni për pesë minuta. Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të
7 Serbisë e ka padit Milovan Dreçunin në Gjykatën serbe për
8 krime lufte, në një "për mashtrim dhe krim të rremë të
9 opinionit në Serbi për gjoja krematorin në Kleçkë" dhe në dy
10 "Për devijimin e fakteve të ngjarë në masakrën e Reçakut" dhe
11 nga krejt kjo që ka rezultuar ky vetëm se është dekoruar nga
12 udhëheqësi ushtarak i luftës në Kosovë dhe tani i dënuar nga
13 Tribunali më 22 vite burg.

14 Kështu që ZPS-ja, e pranoj, jo rastësisht, këtë për
15 koordinator dhe orientimi i kësaj selektiv për mua nuk është i
16 çuditshëm.

17 Ju faleminderit për durimin tuaj në dëgjim dhe kërkoj që
18 sa më shpejt ky rast, kjo çështje të mbyllet.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Vazhdoni
20 z. Cadman.

21 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju falënderoj që lejuat z.
22 Haradinaj të shprehë ato që mendonte.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Siç thashë
24 më përpara, ne do të lëshojmë nesër një vendim të konsoliduar
25 për sqarimin e këtyre çështjeve. Pastaj, do të nxjerrim një

1 urdhër për ecurinë e më tejshme të punës. Do të bëjmë çmos që
2 të marrim parasysh dëshirat e të gjithëve dhe që të sigurojmë
3 ecurinë e mëtejshme të gjyqit.

4 Do t'ju njoftojmë edhe për datën tjetër të seancës.

5 Këtu mbaron kjo seancë.

6 --- Seanca përfundon në orën 12.31

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25